ADEM ZAPLLUZHA

# KUSH I THEU XHAMAT E SHIUT

ADEM ZAPLLUZHA

KUSH I THEU XHAMAT E SHIUT

Redaktor:
Bedri Neziri

Recensent:
Luan Cipi

Lektorë:
Veli Veliu

Piktura në ballin :

Besim Lutolli - Beci

Redaktor:
Bedri Neziri

Recensent:
Luan Cipi

Lektorë:
Veli Veliu

Piktura në ballin :

Besim Lutolli - Beci

**ADEM ZAPLLUZA**

# KUSH I THEU XHAMAT SHIUT

Shtëpia botuese
**TRENDI**
Prishtinë 2019

**ADEM ZAPLLUZA**

KUSH I THEU XHAMAT SHIUT

Shtëpia botuese
**TRENDI**
Prishtinë 2019

***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***



4

Libri 173 i poetit Adem Zaplluzha

Koment letrar nga poeti vlonjat Luan Cipi

Kush e lexon këtë fillim titulli (LIBRI 173) do mendoj se do bëhet fjalë për ndonjë bibliotekë të pasur familjare, që ka 173 libra, ose se kaq është (173), botimi i librave të një institucioni shkencor, apo letrar. Jo, në këtë rast, flasim për një tjetër të vërtetë, që do t'iu çudisë: 173 është numri i librave me poezi, që ka krijuar poeti super produktiv, vetëm 75 vjeçar, Adem Zaplluzha, nga Prizreni i Kosovës. Ai ka botuar deri tani, 163 libra dhe ka të përfunduara, gati për botim edhe 10 të tjera. Janë krijuar prej tij 12 746 poezi, ose 234 516 vargje. Dhe, jo poezi dosido, po të një stili modern të jashtëzakonshëm dhe krejt të lirë, së shumti pa rimë, po mjaftë të këndshme me muzikalitet, rritmë, me fjalë të kërkuara, të zgjedhura e të ëmbla, në një drejtshkrimin besnik bashkëkohor shqiptar, pa asnjë ndërhyrje nga gjuhët e huaja dhe me një kontroll të rreptë gjuhësor e drejtshkrimor.Një karakteristikë dalluese e poezive të Adem Zaplluzhës përbëjnë figurat artistike letrare, me epiqendër metaforat e bukura, që e bëjnë më interesante dhe



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

Libri 173 i poetit Adem Zaplluzha

Koment letrar nga poeti vlonjat Luan Cipi

Kush e lexon këtë fillim titulli (LIBRI 173) do mendoj se do bëhet fjalë për ndonjë bibliotekë të pasur familjare, që ka 173 libra, ose se kaq është (173), botimi i librave të një institucioni shkencor, apo letrar. Jo, në këtë rast, flasim për një tjetër të vërtetë, që do t'iu çudisë: 173 është numri i librave me poezi, që ka krijuar poeti super produktiv, vetëm 75 vjeçar, Adem Zaplluzha, nga Prizreni i Kosovës. Ai ka botuar deri tani, 163 libra dhe ka të përfunduara, gati për botim edhe 10 të tjera. Janë krijuar prej tij 12 746 poezi, ose 234 516 vargje. Dhe, jo poezi dosido, po të një stili modern të jashtëzakonshëm dhe krejt të lirë, së shumti pa rimë, po mjaftë të këndshme me muzikalitet, rritmë, me fjalë të kërkuara, të zgjedhura e të ëmbla, në një drejtshkrimin besnik bashkëkohor shqiptar, pa asnjë ndërhyrje nga gjuhët e huaja dhe me një kontroll të rreptë gjuhësor e drejtshkrimor.Një karakteristikë dalluese e poezive të Adem Zaplluzhës përbëjnë figurat artistike letrare, me epiqendër metaforat e bukura, që e bëjnë më interesante dhe

5

intriguese çdo poezi. Libri 173, që titullohet "KUSH I THEU XHAMAT E SHIUT" është një sukses i ri për krijuesin emërmadh shqiptar, ndofta kampion botëror në togun sasior të titujve të librave nga i njëjti autor. Libri ka 3 cikle kuptim plote, të shtrira në 140 faqe. Në ciklin e parë trajtohet tema: "Si ta ndjejë praninë tënde". Autori e nis me porosinë për "Mos t'i thyer pasqyrat e kujtesës" dhe për mos ta harruar të kaluarën, pranverën dhe puthjet e dikurshme dhe i vetmuar, mallkon të huajt, deri për ndërrimin e emrave të rrugëve. Ai e mbyll ciklin me një poezi dashurie, ku shpjegon se "Mbrëmë ishte ajo që trokiti/ Në dritare.../ Po ju them se ishte ajo,/ Sepse askush nuk di/ Të trokasë kaq bukur në dritaren time...Ajo troket si pikat e shiut/ Kur vjen tek unë, si freskia e pranverës.../ Kush i theu xhamat e shiut?!/ Era apo hija e saj imagjinare?!"

Ciklin e dytë autori e quan: "I dëgjuam disa britma të shurdhëta". Zaplluzha pyet kush i theu xhamat dhe ato ai i destinon kryesisht për t'u mbrojtur nga shiu, pa përmendur funksionet tjera të rëndësishme që xhamat kanë për shtëpinë, këtë çerdhe të ngrohtë familjare, qendër banimi, edukimi dhe



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

intriguese çdo poezi. Libri 173, që titullohet "KUSH I THEU XHAMAT E SHIUT" është një sukses i ri për krijuesin emërmadh shqiptar, ndofta kampion botëror në togun sasior të titujve të librave nga i njëjti autor. Libri ka 3 cikle kuptim plote, të shtrira në 140 faqe. Në ciklin e parë trajtohet tema: "Si ta ndjejë praninë tënde". Autori e nis me porosinë për "Mos t'i thyer pasqyrat e kujtesës" dhe për mos ta harruar të kaluarën, pranverën dhe puthjet e dikurshme dhe i vetmuar, mallkon të huajt, deri për ndërrimin e emrave të rrugëve. Ai e mbyll ciklin me një poezi dashurie, ku shpjegon se "Mbrëmë ishte ajo që trokiti/ Në dritare.../ Po ju them se ishte ajo,/ Sepse askush nuk di/ Të trokasë kaq bukur në dritaren time...Ajo troket si pikat e shiut/ Kur vjen tek unë, si freskia e pranverës.../ Kush i theu xhamat e shiut?!/ Era apo hija e saj imagjinare?!"

Ciklin e dytë autori e quan: "I dëgjuam disa britma të shurdhëta". Zaplluzha pyet kush i theu xhamat dhe ato ai i destinon kryesisht për t'u mbrojtur nga shiu, pa përmendur funksionet tjera të rëndësishme që xhamat kanë për shtëpinë, këtë çerdhe të ngrohtë familjare, qendër banimi, edukimi dhe

6

relaksimi, ku janë pikërisht dyert e dritaret që e bëjnë komode, funksionale, të dashur e të këndshme. Xhamat e dritareve janë tamam ato, që e mbrojnë atë më së tepërmi, nga shiu e bora, po dhe nga era, nga ftoma dhe tej ngrohja.“Kush i theu xhamat e shiut?!” këmbëngul e ripyet autori! “”Era, apo bija e saj e imagjinuar?! Dhe më poshtë: ”Imazhet, zbresin si perënditë.../ Zbresin shkallëve të mendjes kujtimet.”...”për befasinë e të gjithëve,/ Mu bë se dëgjoja zërin e Gjergjit tonë... Dhe në vijim - çdo gjë shqiptare: “Drini i Bardhë” në horizont, “Fusha e Mëllenjave”, “lotët e nënave’’, “valsi i lumturisë’’, “teatri i qytetit”, “dheu i etërve”...Më poshtë vazhdon ‘‘dilema” njerëzore: “Sa herë që desha të jem vetvetja, /Njëqind pengesa/ Më dilnin parasysh.”...”Të jesh, apo të mos jesh?”...”Të ishe grua, unë do isha burrë/ Por tani s’di se çfarë jam  më.”

Dhe nuk vonojnë notat optimiste: “Jam shumë i sigurt,/ Se nuk trokas kot në dyert e qiellit,/ Një ditë do hapen,/ Sepse dashuria njerëzore/ Patjetër do triumfojë.” Diku, në vijim autori qorton Kurbetin: “Më kujtohet, kur u gjenda njëherë/ Në tokën e huaj, Ishte një trishtim shpirtëror/ Të shikosh vetveten/



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

relaksimi, ku janë pikërisht dyert e dritaret që e bëjnë komode, funksionale, të dashur e të këndshme. Xhamat e dritareve janë tamam ato, që e mbrojnë atë më së tepërmi, nga shiu e bora, po dhe nga era, nga ftoma dhe tej ngrohja.“Kush i theu xhamat e shiut?!” këmbëngul e ripyet autori! “”Era, apo bija e saj e imagjinuar?! Dhe më poshtë: ”Imazhet, zbresin si perënditë.../ Zbresin shkallëve të mendjes kujtimet.”...”për befasinë e të gjithëve,/ Mu bë se dëgjoja zërin e Gjergjit tonë... Dhe në vijim - çdo gjë shqiptare: “Drini i Bardhë” në horizont, “Fusha e Mëllenjave”, “lotët e nënave’’, “valsi i lumturisë’’, “teatri i qytetit”, “dheu i etërve”...Më poshtë vazhdon ‘‘dilema” njerëzore: “Sa herë që desha të jem vetvetja, /Njëqind pengesa/ Më dilnin parasysh.”...”Të jesh, apo të mos jesh?”...”Të ishe grua, unë do isha burrë/ Por tani s’di se çfarë jam  më.”

Dhe nuk vonojnë notat optimiste: “Jam shumë i sigurt,/ Se nuk trokas kot në dyert e qiellit,/ Një ditë do hapen,/ Sepse dashuria njerëzore/ Patjetër do triumfojë.” Diku, në vijim autori qorton Kurbetin: “Më kujtohet, kur u gjenda njëherë/ Në tokën e huaj, Ishte një trishtim shpirtëror/ Të shikosh vetveten/

7

Duke vdekur ngadalë.” Dhe këtë largim e shpjegon me faktin se ”Atdheu im ishte një tokë pa diell,/ Hëna e ngrirë/ Mbrëmjeve të vona...Në ciklin e tretë autori thur poezi “PËR HERONJTË DHE MASKARENJTË”. Për “titanët e kombit dhe për liliputët burracakë” Ai krenohet se : “Kjo tokë, ky Atdhe, s’janë të varfër./ Kanë një gjuhë me tri fe”, ku përshëndeten “Mirëmëngjesi”, “Mirëdita” dhe ”Natën e mirë” dhe më tej krenohet se “Këtë tokë të bekuar nga perënditë/ Askush nuk e solli këtu,/ Kur zbritën nga qielli/ etërit e mi.../ Nga ne ardhacakët mësuan sesi ndizet zjarri.’’E lexon me endje librin e 173.-të  me poezi të Adem Zaplluzhës dhe mbushe me krenari prej penës së artë të tij, që ka skalitur kaq bukur vargje elitare të pashlyera nga kujtesa, me fjalë të qëmtuara të gjuhës së njësuar zyrtare shqipe dhe bindesh kështu, se leksiku jonë, është një pasuri e madhe e gjerë dhe e bukur dhe se poeti ynë i kujdesshëm  shumë produktiv dhe cilësor, e ka përdorur atë me mjeshtëri.

Suksese të mëtejshme!

Vlorë, më 12.09. 2018



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Duke vdekur ngadalë.” Dhe këtë largim e shpjegon me faktin se ”Atdheu im ishte një tokë pa diell,/ Hëna e ngrirë/ Mbrëmjeve të vona...Në ciklin e tretë autori thur poezi “PËR HERONJTË DHE MASKARENJTË”. Për “titanët e kombit dhe për liliputët burracakë” Ai krenohet se : “Kjo tokë, ky Atdhe, s’janë të varfër./ Kanë një gjuhë me tri fe”, ku përshëndeten “Mirëmëngjesi”, “Mirëdita” dhe ”Natën e mirë” dhe më tej krenohet se “Këtë tokë të bekuar nga perënditë/ Askush nuk e solli këtu,/ Kur zbritën nga qielli/ etërit e mi.../ Nga ne ardhacakët mësuan sesi ndizet zjarri.’’E lexon me endje librin e 173.-të  me poezi të Adem Zaplluzhës dhe mbushe me krenari prej penës së artë të tij, që ka skalitur kaq bukur vargje elitare të pashlyera nga kujtesa, me fjalë të qëmtuara të gjuhës së njësuar zyrtare shqipe dhe bindesh kështu, se leksiku jonë, është një pasuri e madhe e gjerë dhe e bukur dhe se poeti ynë i kujdesshëm  shumë produktiv dhe cilësor, e ka përdorur atë me mjeshtëri.

Suksese të mëtejshme!

Vlorë, më 12.09. 2018

8

*Cikli i parë*

*Si ta ndjej pranin tënde*



***<u>Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.</u>***

*Cikli i parë*

*Si ta ndjej pranin tënde*

9

***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***


10

## VETËM NË BRENDINË E PASQYRËS

Mos i thyej pasqyrat
Në akullin e kujtesës!
As muret e lagështa të së kaluarës!
Mos i prek asnjëherë,
Me gishtat e tua të hollë!

Do e vrasësh pranverën
Do i vrasësh edhe puthjet e panumërta...

Sonte nuk jam i vetëm,
Me mua është vetmia e dërmuar
Dhe flokët e tua të thinjura.

Kjo pemë e egër
Që i paska lëshuar rrënjët kaq thellë,
Ka zënë e po thahet
Në stuhinë e një kohe shterpane.

Më duket se kam mbetur pa asnjë kujtim,
Edhe gjethet e vjeshtës paskan vdekur,
Disa shtërgje sonte fluturuan
Nga çatia ime dhe më thanë se ky qytet nuk



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

VETËM NË BRENDINË E PASQYRËS

Mos i thyej pasqyrat
Në akullin e kujtesës!
As muret e lagështa të së kaluarës!
Mos i prek asnjëherë,
Me gishtat e tua të hollë!

Do e vrasësh pranverën
Do i vrasësh edhe puthjet e panumërta...

Sonte nuk jam i vetëm,
Me mua është vetmia e dërmuar
Dhe flokët e tua të thinjura.

Kjo pemë e egër
Që i paska lëshuar rrënjët kaq thellë,
Ka zënë e po thahet
Në stuhinë e një kohe shterpane.

Më duket se kam mbetur pa asnjë kujtim,
Edhe gjethet e vjeshtës paskan vdekur,
Disa shtërgje sonte fluturuan
Nga çatia ime dhe më thanë se ky qytet nuk

11

është më i imi.
Erdhën të huajt
Dhe ua ndërruan emrat e rrugëve.

Frynte një erë e pakëndshme...
Nga kjo perspektivë,
Qyteti duket si një paçavure mbi gardh.

Asnjë kambanë nuk dëgjuam mbrëmë,
Vetëm në brenditë e pasqyrave,
Qante një kërthi
I lindur në gjysmën e parë të shekullit
njëzetë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

është më i imi.
Erdhën të huajt
Dhe ua ndërruan emrat e rrugëve.

Frynte një erë e pakëndshme...
Nga kjo perspektivë,
Qyteti duket si një paçavure mbi gardh.

Asnjë kambanë nuk dëgjuam mbrëmë,
Vetëm në brenditë e pasqyrave,
Qante një kërthi
I lindur në gjysmën e parë të shekullit
njëzetë.

12

## NËPËR MURET E RRËNUARA

Asnjë zë nuk dëgjuam mbrëmë,
Por lumi qante,
Dëneste si një kërthi i braktisur
Në altarin e kujtesës.

Dëneste për kohën e humbur
Mes gishtave anemike të shiut.

Mbase vdiqën perënditë paganë!
S'dëgjuam asnjë lutje
Për të nesërmen e dyshimtë.

Nga buzët e ndryshkura të ikonave,
Lëvareshin myshqet e verdha
Nëpër muret e rrënuara.

Nuk isha as i pari, as kalimtari i fundit.
Nata e sterrët
Si e çmendur kishte humbur kujtesën.

Nuk më njohu asnjë qen  i lagjes,
Mbase ai i Uliksit
Kishte humbur mendjen nga frika.



***Kush i theu xhamat e shiut  Adem .Z.***

NËPËR MURET E RRËNUARA

Asnjë zë nuk dëgjuam mbrëmë,
Por lumi qante,
Dëneste si një kërthi i braktisur
Në altarin e kujtesës.

Dëneste për kohën e humbur
Mes gishtave anemike të shiut.

Mbase vdiqën perënditë paganë!
S'dëgjuam asnjë lutje
Për të nesërmen e dyshimtë.

Nga buzët e ndryshkura të ikonave,
Lëvareshin myshqet e verdha
Nëpër muret e rrënuara.

Nuk isha as i pari, as kalimtari i fundit.
Nata e sterrët
Si e çmendur kishte humbur kujtesën.

Nuk më njohu asnjë qen  i lagjes,
Mbase ai i Uliksit
Kishte humbur mendjen nga frika.

13

## QANIN FATKEQËSINË E NJË FATKEQËSIE

Shiu i mbrëmshëm,
një shi i hidhur,
Me shijen e uthullës,
Dhe aromën e tokës,
Shtrihej mbi vesën e mëngjesit.

Shtrihej si bualli i lodhur
Nën diellin përcëllues të mesditës.

Nën shelgjishtet e pikëlluara,
Nuk pushonte asnjë shtërg.

Udhëtari i fundit që shuajti etjen,
Ka kohë që nuk ishte mes të gjallëve.
Mbase gjeti strehim
Të përkohshëm në amshim.

Kambana dhe kryqi i vjetër
Kishin nga një tregim në vete,
Qanin mbi muranat e rrënuara,
Qanin fatin e një fatkeqësie
Të cilin e përjetoi
Brendia e pasqyrës së thyer.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

QANIN FATKEQËSINË E NJË FATKEQËSIE

Shiu i mbrëmshëm,
një shi i hidhur,
Me shijen e uthullës,
Dhe aromën e tokës,
Shtrihej mbi vesën e mëngjesit.

Shtrihej si bualli i lodhur
Nën diellin përcëllues të mesditës.

Nën shelgjishtet e pikëlluara,
Nuk pushonte asnjë shtërg.

Udhëtari i fundit që shuajti etjen,
Ka kohë që nuk ishte mes të gjallëve.
Mbase gjeti strehim
Të përkohshëm në amshim.

Kambana dhe kryqi i vjetër
Kishin nga një tregim në vete,
Qanin mbi muranat e rrënuara,
Qanin fatin e një fatkeqësie
Të cilin e përjetoi
Brendia e pasqyrës së thyer.

14

## NDOSHTA IA MBANIN "ISON" E TEATRIT TË QYTETIT

Binte një shi pa ngjyrë dhe shije.
Shiu,i shëmbëllente
Ajrit të ndotur të Prishtinës.

Teatri i qytetit,
i lëshoi perdet në gjysmë shtize.

Mbase vajtonte vetëvrasjen e kohës.

Edhe mjegulla qante si një kërthi,
Qante fatin e faltores së rrënuar.

Asnjë mur s’kishte mbetur
Në themelet e vjetra,
Ikën edhe gurët e vendosur
Që në fillim të ditës.

Kurse shiu, i tredhur idhnak
Nuk dinte përse qante,
Fatin e vet fatkeq, ose fatin e zogjve
Të lagur deri në asht'.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

NDOSHTA IA MBANIN "ISON" E TEATRIT TË QYTETIT

Binte një shi pa ngjyrë dhe shije.
Shiu,i shëmbëllente
Ajrit të ndotur të Prishtinës.

Teatri i qytetit,
i lëshoi perdet në gjysmë shtize.

Mbase vajtonte vetëvrasjen e kohës.

Edhe mjegulla qante si një kërthi,
Qante fatin e faltores së rrënuar.

Asnjë mur s’kishte mbetur
Në themelet e vjetra,
Ikën edhe gurët e vendosur
Që në fillim të ditës.

Kurse shiu, i tredhur idhnak
Nuk dinte përse qante,
Fatin e vet fatkeq, ose fatin e zogjve
Të lagur deri në asht'.

15

Në shkallët e teatrit,
dëneste një trishtil.

Disa udhëtarë të vonshëm,
Bridhnin rrugëve të kalldrëmta.

Të gjitha dritaret e hoteleve
I mbanin të mbyllura perdet,
Ndoshta mbanin "ison" e teatrit të qytetit.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Në shkallët e teatrit,
dëneste një trishtil.

Disa udhëtarë të vonshëm,
Bridhnin rrugëve të kalldrëmta.

Të gjitha dritaret e hoteleve
I mbanin të mbyllura perdet,
Ndoshta mbanin "ison" e teatrit të qytetit.

16

## MBAS HAPIT TË NËNTË

Jo që munda,
Por arrita në fund të rrugës.

Arrita para të gjithëve
Të kuptoj sekretin e pasqyrës.

Se jeta është një gotë e kristaltë,
E cila zbrazet,
sapo ta mbushësh.

Mos mendoni se këtu është fundi.
Fundi as që ekziston diku,
Hapi i tij është që në fillim.

Mbas hapit të nëntë,
Takohemi me portat e ferrit,
Të cilat kurrë nuk dinë të mbyllen...

Njeriu në jetë,
gjithmonë hulumton
ta gjej të pamundurën.
T'i gjej duart e erës
Në shpirtin e etur të shakullinës,
Por mjerisht s'mund ta shohësh
Shakullinën e tmerrshme e cila të gllabëron.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

MBAS HAPIT TË NËNTË

Jo që munda,
Por arrita në fund të rrugës.

Arrita para të gjithëve
Të kuptoj sekretin e pasqyrës.

Se jeta është një gotë e kristaltë,
E cila zbrazet,
sapo ta mbushësh.

Mos mendoni se këtu është fundi.
Fundi as që ekziston diku,
Hapi i tij është që në fillim.

Mbas hapit të nëntë,
Takohemi me portat e ferrit,
Të cilat kurrë nuk dinë të mbyllen...

Njeriu në jetë,
gjithmonë hulumton
ta gjej të pamundurën.
T'i gjej duart e erës
Në shpirtin e etur të shakullinës,
Por mjerisht s'mund ta shohësh
Shakullinën e tmerrshme e cila të gllabëron.

17

## NJË NËNË DËNESTE KACULE MBI NJË VARR

Kur i pamë të vdekurit,
Ishte tepër vonë.
Dielli kishte ikur pas shtatë bjeshkëve.
Vetëm klithmat e eshtrave
I dëgjuam kah vajtonin si shelgu i pikëlluar.

Askënd s’pata mundësi të pyes.
A thua vallë  ishte natë,
Ose një ditë të cilën s’dua kurrë ta
përkujtoj?!

Gjithsesi,
ishte një klithmë e trishtuar,
Sa që qante edhe kambana e thyer.

Dielli si një dem i zi dhe i çmendur,
Galoponte nëpër thellësinë e tokës,
Galoponte si kuajt e paçjerrë.

Asnjë njeri s’ishte në gjendje
Ta përshkruaj tmerrin e një ushtrie barbare.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

NJË NËNË DËNESTE KACULE MBI NJË VARR

Kur i pamë të vdekurit,
Ishte tepër vonë.
Dielli kishte ikur pas shtatë bjeshkëve.
Vetëm klithmat e eshtrave
I dëgjuam kah vajtonin si shelgu i pikëlluar.

Askënd s’pata mundësi të pyes.
A thua vallë  ishte natë,
Ose një ditë të cilën s’dua kurrë ta
përkujtoj?!

Gjithsesi,
ishte një klithmë e trishtuar,
Sa që qante edhe kambana e thyer.

Dielli si një dem i zi dhe i çmendur,
Galoponte nëpër thellësinë e tokës,
Galoponte si kuajt e paçjerrë.

Asnjë njeri s’ishte në gjendje
Ta përshkruaj tmerrin e një ushtrie barbare.

18

Dikur,
vonë ,
kur mejtën dhembjet,

Kjo botë e tmerrit
Si në një hon të pafund
U fundos në shpirtin tim të vrarë.
Një nënë dëneste kacule mbi një varr.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Dikur,
vonë ,
kur mejtën dhembjet,

Kjo botë e tmerrit
Si në një hon të pafund
U fundos në shpirtin tim të vrarë.
Një nënë dëneste kacule mbi një varr.

19

**SHIKONIM HËNËN LAKURIQE**

Një dallgë e shqetësuar
Në shpirtin tim.
Një det i pafund
me dhembje...

Të kujt janë këto duar
Që po u ngjajnë rremave
Të një varke të fundosur?!

Dy anije në horizont
Me nga një degë ulliri janë nisur
Për askund.

Kanë marr një udhë të pafund.
Udhë e cila njëherë e përgjithmonë
Do të përfundojë askund.

Për befasinë e të gjithëve,
Kuptuam se si qante deti,
Qante edhe hukama e një guaske...

Nëpër mole,
pamë njerëz të stepur
Shikonin  hënën lakuriqe
E cila s’mundi ta përjetoj eklipsin e dytë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**SHIKONIM HËNËN LAKURIQE**

Një dallgë e shqetësuar
Në shpirtin tim.
Një det i pafund
me dhembje...

Të kujt janë këto duar
Që po u ngjajnë rremave
Të një varke të fundosur?!

Dy anije në horizont
Me nga një degë ulliri janë nisur
Për askund.

Kanë marr një udhë të pafund.
Udhë e cila njëherë e përgjithmonë
Do të përfundojë askund.

Për befasinë e të gjithëve,
Kuptuam se si qante deti,
Qante edhe hukama e një guaske...

Nëpër mole,
pamë njerëz të stepur
Shikonin  hënën lakuriqe
E cila s’mundi ta përjetoj eklipsin e dytë.

20

## SA HERË QË STATUJAT E SHENJTA

Diçka si zbulim i mistershëm,
Ose parafytyrim,
më del parasysh.

Pema, ka një pamje ekzotike.
Nga gjethet e venitura si vesa,
Pikojnë çastet e humbura të jetës.

Gjithmonë kam menduar se diçka e tillë
Nuk ka ekzistuar,
Por kur pamë ekuinoksin,
Syrin e shtatë të hënës,
Një hije e keqe u ra gjetheve.

Atë vit përjetuam një dimër madhështor.
Askush s'guxonte
Të thotë asnjë fjalë për etërit tanë.
Në mesin e kolonadave miniaturale,
Dukeshin të shenjtë si perëndite.

Ngjanin me Zotat e Olimpit,
Merrnin frymë si përmendoret antike,
Sa herë që statujat
i shtrëngonin grushtet e mermerta,
Pikonte një lloj i mistershëm gjaku.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

SA HERË QË STATUJAT E SHENJTA

Diçka si zbulim i mistershëm,
Ose parafytyrim,
më del parasysh.

Pema, ka një pamje ekzotike.
Nga gjethet e venitura si vesa,
Pikojnë çastet e humbura të jetës.

Gjithmonë kam menduar se diçka e tillë
Nuk ka ekzistuar,
Por kur pamë ekuinoksin,
Syrin e shtatë të hënës,
Një hije e keqe u ra gjetheve.

Atë vit përjetuam një dimër madhështor.
Askush s'guxonte
Të thotë asnjë fjalë për etërit tanë.
Në mesin e kolonadave miniaturale,
Dukeshin të shenjtë si perëndite.

Ngjanin me Zotat e Olimpit,
Merrnin frymë si përmendoret antike,
Sa herë që statujat
i shtrëngonin grushtet e mermerta,
Pikonte një lloj i mistershëm gjaku.

21

## MBASE KËNDONTE DETl

Mbrëmë,
në vend se të këndonte deti,
këndoi një guaskë e verdhë.

Dëgjova se si qante një mjellmë,
Mbi kiçin e thyer të anijes pa rrema.

Ishte një natë rebele.
Peshqit kishin mbetur pa racionin e tyre,
Asnjë kokërr kripe,
S’lëpinte era e trullosur.

Nga taverna e vjetër e molit,
Dëgjohej një muzikë e lashtë,
Mbase këndonte deti
Psalmet e vdekura të një kohe.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

MBASE KËNDONTE DETl

Mbrëmë,
në vend se të këndonte deti,
këndoi një guaskë e verdhë.

Dëgjova se si qante një mjellmë,
Mbi kiçin e thyer të anijes pa rrema.

Ishte një natë rebele.
Peshqit kishin mbetur pa racionin e tyre,
Asnjë kokërr kripe,
S’lëpinte era e trullosur.

Nga taverna e vjetër e molit,
Dëgjohej një muzikë e lashtë,
Mbase këndonte deti
Psalmet e vdekura të një kohe.

22

**QANIN EDHE ZOGJTË**

Nata dukej e sikletshme,
Nuk u dëgjuan hingëllimat e kuajve.

Njerëzit,
u shndërruan
në përmendore të mermerta.
Heshtën si gurtë e murrmë të dhembjes.

Nuk desha të jem ai që nuk jam.
Reagova ndaj kësaj dukurie
Të paparë çnjerëzore.

Një grua e moshuar,
Qante pranë përmendores,
Qanin edhe zogjtë në fluturim.

Lejleku mbi oxhakun e kujtesës,
Recitonte poemën e Mjedës,
Dhe kélthiste trishtueshëm
Si një kërthi i braktisur në altar.

Nuk isha në gjendje të bëja asgjë,
Por as për të heshtur,
nuk heshta.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**QANIN EDHE ZOGJTË**

Nata dukej e sikletshme,
Nuk u dëgjuan hingëllimat e kuajve.

Njerëzit,
u shndërruan
në përmendore të mermerta.
Heshtën si gurtë e murrmë të dhembjes.

Nuk desha të jem ai që nuk jam.
Reagova ndaj kësaj dukurie
Të paparë çnjerëzore.

Një grua e moshuar,
Qante pranë përmendores,
Qanin edhe zogjtë në fluturim.

Lejleku mbi oxhakun e kujtesës,
Recitonte poemën e Mjedës,
Dhe kélthiste trishtueshëm
Si një kërthi i braktisur në altar.

Nuk isha në gjendje të bëja asgjë,
Por as për të heshtur,
nuk heshta.

23

Pështyva murin e turpit,
Pështyva një urrejtjeje,
Që rritej si uragan në shpirtin tim.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Pështyva murin e turpit,
Pështyva një urrejtjeje,
Që rritej si uragan në shpirtin tim.

24

## VETËM GRATË E MARINARËVE

Ishin disa çaste sublime,
delikate,
Si sqepat e mjellmave.

Nga pendlat e purpurta të detit,
Dolën peshqit e ngordhur fluturues.

Atë çast i theve të katër pasqyrat,
Ose e tërë lagjja i theu
të shtatëqind
Pasqyrat konkave
Në lotin e trishtuar të diellit.

Nga thellësia si tallaze gjigante të mëdha
që i ngjanin shpirtit të detit,
Dolën si një hukamë e trishtuar,
Dolën dhe morën dheun meduzat.

Më pastaj,
ra një heshtje e madhe...

Asnjë zë nuk doli nga thellësia,
Vetëm gratë e marinarëve,
Me shamitë e bardha,
i pritnin arkivolet!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

## VETËM GRATË E MARINARËVE

Ishin disa çaste sublime,
delikate,
Si sqepat e mjellmave.

Nga pendlat e purpurta të detit,
Dolën peshqit e ngordhur fluturues.

Atë çast i theve të katër pasqyrat,
Ose e tërë lagjja i theu
të shtatëqind
Pasqyrat konkave
Në lotin e trishtuar të diellit.

Nga thellësia si tallaze gjigante të mëdha
që i ngjanin shpirtit të detit,
Dolën si një hukamë e trishtuar,
Dolën dhe morën dheun meduzat.

Më pastaj,
ra një heshtje e madhe...

Asnjë zë nuk doli nga thellësia,
Vetëm gratë e marinarëve,
Me shamitë e bardha,
i pritnin arkivolet!

25

## FLASIN KUR MEN ERA

Thërras, këlthas e bërtas,
Askush nuk më dëgjon!

Kjo dhembje e brendshme
Si pula e egër,
Çukit në shpirtin e drurit.

Çukit ag e terr,
Sa që s'gjen dot askund shërim.

Kjo stinë e vdekjeve,
sapo ka filluar.
Nën hijen e arrës,
Ngordhën kandrat e zeza.

Këto pamje mistike,
kanë një tjetër gjuhë...
Flasin kur men era,
Dhe u dëgjohen britmat
Kur çmenden stuhitë e egra.

Më duket se një tufan i madh,
Do ngjaj para heshtjes.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

FLASIN KUR MEN ERA

Thërras, këlthas e bërtas,
Askush nuk më dëgjon!

Kjo dhembje e brendshme
Si pula e egër,
Çukit në shpirtin e drurit.

Çukit ag e terr,
Sa që s'gjen dot askund shërim.

Kjo stinë e vdekjeve,
sapo ka filluar.
Nën hijen e arrës,
Ngordhën kandrat e zeza.

Këto pamje mistike,
kanë një tjetër gjuhë...
Flasin kur men era,
Dhe u dëgjohen britmat
Kur çmenden stuhitë e egra.

Më duket se një tufan i madh,
Do ngjaj para heshtjes.

26

***<u>Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.</u>***

Gjërat, paskan filluar të ndryshojnë
Për së prapthi.
Ajo nuk ishte këtu,
kur ndodhi ikja e madhe.

Asnjë pëllumb
nuk mbeti mbi çati,
Fluturuan edhe zogjtë e fundit te vjeshtës.



***<u>Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.</u>***

Gjërat, paskan filluar të ndryshojnë
Për së prapthi.
Ajo nuk ishte këtu,
kur ndodhi ikja e madhe.

Asnjë pëllumb
nuk mbeti mbi çati,
Fluturuan edhe zogjtë e fundit te vjeshtës.

27

## SI TA NDJEJ PRANINË TËNDE

Ndonjëherë,
besa edhe çdo ditë,
Më pengon prania ime.

Nuk ndjej afër meje,
As pranin e mushkonjës...
Zëzëllima e së cilës
Më bën të çmendem.

Si ta ndjej praninë tënde
Në këtë dhomë kaq të mistershme?!

Sa herë që i theva pasqyrat
Në korridorin e fëmijërisë,
Nuk i gjeta asnjëherë
Duart e tua të humbura.

Të thashë se ti nuk ishe askund.

I shkunda të gjitha tregimet
Nga kashelashat kërkova ndihmë,
Nuk ishe në asnjë baladë
Ku ta gjej pra
Eliksirin për shërimin e plagëve?!
Më thuaj ku ta gjej?



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

SI TA NDJEJ PRANINË TËNDE

Ndonjëherë,
besa edhe çdo ditë,
Më pengon prania ime.

Nuk ndjej afër meje,
As pranin e mushkonjës...
Zëzëllima e së cilës
Më bën të çmendem.

Si ta ndjej praninë tënde
Në këtë dhomë kaq të mistershme?!

Sa herë që i theva pasqyrat
Në korridorin e fëmijërisë,
Nuk i gjeta asnjëherë
Duart e tua të humbura.

Të thashë se ti nuk ishe askund.

I shkunda të gjitha tregimet
Nga kashelashat kërkova ndihmë,
Nuk ishe në asnjë baladë
Ku ta gjej pra
Eliksirin për shërimin e plagëve?!
Më thuaj ku ta gjej?

28

## ME MUAJ S'FOLA ASNJË FJALË

Vetë e vrava
Dhe e qava zotin tim.
Më duket se kurrë nuk ishte për mua.
I ngjante një trupi gjeometrik,
Në formën e lëngësht.

Njëherë e preka rastësisht,
Kur pastaj e putha,
Me qindra puçrra të verdha
Vërshuan në gjuhën time,
Me muaj s'fola asnjë fjalë.

Nuk më kujtohet,
ndoshta edhe s'dija
Se si dukej kryqi im?!

I ngjante kryqit të fqinjëve të mi,
Apo kishte një tjetër formë?!



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

ME MUAJ S'FOLA ASNJË FJALË

Vetë e vrava
Dhe e qava zotin tim.
Më duket se kurrë nuk ishte për mua.
I ngjante një trupi gjeometrik,
Në formën e lëngësht.

Njëherë e preka rastësisht,
Kur pastaj e putha,
Me qindra puçrra të verdha
Vërshuan në gjuhën time,
Me muaj s'fola asnjë fjalë.

Nuk më kujtohet,
ndoshta edhe s'dija
Se si dukej kryqi im?!

I ngjante kryqit të fqinjëve të mi,
Apo kishte një tjetër formë?!

29

Ose ende nuk di
se çfarë forme kishte?!

Vetë e vrava dhe e qava
Zotin tim.

Kryqi ishte një copë metali,
Forma e të cilit ndryshohej
Sa herë vinin dhe shkonin ushtarët e huaj.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Ose ende nuk di
se çfarë forme kishte?!

Vetë e vrava dhe e qava
Zotin tim.

Kryqi ishte një copë metali,
Forma e të cilit ndryshohej
Sa herë vinin dhe shkonin ushtarët e huaj.

30

## FËMIJË DELIKAT

As ti s'ishe Zot,
E as unë engjëll,
Mbase ne të dy
Ishim shpirtra pagan.

Sa herë që na zgjonte një ëndërr,
Qëndronim në korridor
Me nga një, ose dy pasqyra
Të thyera në dorë.

Nuk ishim djaj,
e as bijtë e djajve,
Ishim të vegjël,
fëmijë delikat.
Dikur vonë na mësuam
Të jetojmë
me përditshmërinë e dhunës



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

FËMIJË DELIKAT

As ti s'ishe Zot,
E as unë engjëll,
Mbase ne të dy
Ishim shpirtra pagan.

Sa herë që na zgjonte një ëndërr,
Qëndronim në korridor
Me nga një, ose dy pasqyra
Të thyera në dorë.

Nuk ishim djaj,
e as bijtë e djajve,
Ishim të vegjël,
fëmijë delikat.
Dikur vonë na mësuam
Të jetojmë
me përditshmërinë e dhunës

31

**NUK MËSOVA SE CILI JAM**

Nuk di,
Asgjë s'kuptoj,
A thua vallë ishte Zoti,
Apo djalli
Që e vrava në veten time?!

Unë dikë vrava,
Jam vrasës apo engjëll?!

Tani në brendinë time
Të zbrazët
Nuk jeton më askush.

Askush përpos boshllëkut
Që buçet në mua,
Oshtinë si det' i verbër.

Më besoni asnjëherë
Nuk mësova se cili jam?!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**NUK MËSOVA SE CILI JAM**

Nuk di,
Asgjë s'kuptoj,
A thua vallë ishte Zoti,
Apo djalli
Që e vrava në veten time?!

Unë dikë vrava,
Jam vrasës apo engjëll?!

Tani në brendinë time
Të zbrazët
Nuk jeton më askush.

Askush përpos boshllëkut
Që buçet në mua,
Oshtinë si det' i verbër.

Më besoni asnjëherë
Nuk mësova se cili jam?!

32

## DJALLI

Kur i lexoj letrat e tua,
Më duket se jam dikush tjetër...
Sot një djall i zi
Hyri në dhomë time
Dhe copë e grimë i bëri dritaret.

Ne deshëm,
Madje dëshiruam shumë
T'ia thyenim kokën...
Por si t'ia thyesh kokën
Kur djalli s’ka kokë,
As bisht ku ta kapësh?!

Deshëm t'ia merrnim shpirtin...
U bëmë qesharak,
Kur menduam si kalamaj
Për një gjë të tillë.

Por ku ka shpirt djalli i zi?!

Dikur vonë,tepër vonë
Gati u alivanosa
Nga qeshja.

Në atë gjendje ishe edhe ti
Mbase djalli na përfshiu që të dy.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

DJALLI

Kur i lexoj letrat e tua,
Më duket se jam dikush tjetër...
Sot një djall i zi
Hyri në dhomë time
Dhe copë e grimë i bëri dritaret.

Ne deshëm,
Madje dëshiruam shumë
T'ia thyenim kokën...
Por si t'ia thyesh kokën
Kur djalli s’ka kokë,
As bisht ku ta kapësh?!

Deshëm t'ia merrnim shpirtin...
U bëmë qesharak,
Kur menduam si kalamaj
Për një gjë të tillë.

Por ku ka shpirt djalli i zi?!

Dikur vonë,tepër vonë
Gati u alivanosa
Nga qeshja.

Në atë gjendje ishe edhe ti
Mbase djalli na përfshiu që të dy.

33

**GISHTËRINJTË E MIA TË VERBËTA**

Nuk di në çfarë gjendje jam
Kur i prek kartolinat e tua.
Më duket se
Jam tërësisht i verbër,
Asgjë nuk ndjejnë gishtërinjtë e mi.

Nuk shoh asnjë shkronjë
Që u shkrua me gjak.

Sa herë që i prek,
Ndjej nëpër shqisat e  ajrit
Një aromë të kuqe ngrohtësie.

Gishtërinjtë e mi të verbër
Dhe letrat e tua të shkruara dikur
Pa mendje e pa sy.
Kush mund t’i lexojë këto arabeska
Të shkarravitura në rërë për ty?!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**GISHTËRINJTË E MIA TË VERBËTA**

Nuk di në çfarë gjendje jam
Kur i prek kartolinat e tua.
Më duket se
Jam tërësisht i verbër,
Asgjë nuk ndjejnë gishtërinjtë e mi.

Nuk shoh asnjë shkronjë
Që u shkrua me gjak.

Sa herë që i prek,
Ndjej nëpër shqisat e  ajrit
Një aromë të kuqe ngrohtësie.

Gishtërinjtë e mi të verbër
Dhe letrat e tua të shkruara dikur
Pa mendje e pa sy.
Kush mund t’i lexojë këto arabeska
Të shkarravitura në rërë për ty?!

34

**ATË DITË ISHTE E PREMTE**

Ti nuk pate asnjë letër
Në duart e tua delikate,
As kartolinë në dorë,
I shkruaje diku në ajër
Letrat e tua të dashurisë.

Mbase ti s’dije të shkruaje
Nëpër pergamena.
Ty nuk të interesonte poezia...
Në secilën letër
Pate harruar të shënosh emrin tënd.
Harrove,
ose nuk deshe.

Letrat e tua të palexuara
Ende sot gjenden të vetmuara,
Gjenden në sirtarin e kujtimeve
Që nuk mund t’i lexojë askush.

Atë ditë,
kur binte një rrebesh i çmendur,
Mbase ishte ditë e premte,
Kur u shndërrove në erë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**ATË DITË ISHTE E PREMTE**

Ti nuk pate asnjë letër
Në duart e tua delikate,
As kartolinë në dorë,
I shkruaje diku në ajër
Letrat e tua të dashurisë.

Mbase ti s’dije të shkruaje
Nëpër pergamena.
Ty nuk të interesonte poezia...
Në secilën letër
Pate harruar të shënosh emrin tënd.
Harrove,
ose nuk deshe.

Letrat e tua të palexuara
Ende sot gjenden të vetmuara,
Gjenden në sirtarin e kujtimeve
Që nuk mund t’i lexojë askush.

Atë ditë,
kur binte një rrebesh i çmendur,
Mbase ishte ditë e premte,
Kur u shndërrove në erë.

35

Si mund të lexohen letrat
Në një hapësirë,
pa ngjyrë dhe shije?!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Si mund të lexohen letrat
Në një hapësirë,
pa ngjyrë dhe shije?!

36

## AS PIKAT E SHIUT, AS HAPAT E TUA

Nuk di,
a thua vallë ishte shiu,
apo hapat e tua
që trokitnin nëpër kalldrëmet e qytetit?!

Por gjithsesi
Deri në mëngjes nuk u ndalën vigmat e natës.

Unë mbeta pa fije gjumi.
Herë dëgjoja pikat e shiut
Nëpër xhama e dhomës së gjumit,
E herë të lehurat e pakuptimta të yjeve
Nëpër kalldrëmet e lagura.

Me duket se tok me shiun,
Laheshin të gjitha mëkatet tona.

Kur në mëngjes më zgjuan këndesat,
Asgjë nuk pashë rrugëve
As rigat e shiut tok me hapat e tua.



Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.

AS PIKAT E SHIUT, AS HAPAT E TUA

Nuk di,
a thua vallë ishte shiu,
apo hapat e tua
që trokitnin nëpër kalldrëmet e qytetit?!

Por gjithsesi
Deri në mëngjes nuk u ndalën vigmat e natës.

Unë mbeta pa fije gjumi.
Herë dëgjoja pikat e shiut
Nëpër xhama e dhomës së gjumit,
E herë të lehurat e pakuptimta të yjeve
Nëpër kalldrëmet e lagura.

Me duket se tok me shiun,
Laheshin të gjitha mëkatet tona.

Kur në mëngjes më zgjuan këndesat,
Asgjë nuk pashë rrugëve
As rigat e shiut tok me hapat e tua.

37

## VETËM PASQYRA NË KORRIDOR

Kur zgjohem esëll,
Ose më zgjojnë këndesat,
Unë nuk di se kush jam?!

Çdo natë dalë nga një ëndërr
Dhe fundosem si peshku,
Në ëndrrën e një deti tjetër.

Kur hap sytë në mëngjes,
Spektri i ngjyrave
Më paraqitet para syve.
Isha në Ferr apo  në Parajsë?!

Por gjithsesi isha diku,
Larg dhomës sime,
me ëndrrat e tua.

Kur zhdehem tërë trishtim
Nga ky gjumë i përdalë,
Prek gjymtyrët e mia.
Më duken se janë të huaja.

Vetëm pasqyra në korridor
Nuk ishte asnjëherë në ëndrrën time.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

VETËM PASQYRA NË KORRIDOR

Kur zgjohem esëll,
Ose më zgjojnë këndesat,
Unë nuk di se kush jam?!

Çdo natë dalë nga një ëndërr
Dhe fundosem si peshku,
Në ëndrrën e një deti tjetër.

Kur hap sytë në mëngjes,
Spektri i ngjyrave
Më paraqitet para syve.
Isha në Ferr apo  në Parajsë?!

Por gjithsesi isha diku,
Larg dhomës sime,
me ëndrrat e tua.

Kur zhdehem tërë trishtim
Nga ky gjumë i përdalë,
Prek gjymtyrët e mia.
Më duken se janë të huaja.

Vetëm pasqyra në korridor
Nuk ishte asnjëherë në ëndrrën time.

38

**NUK I BESOVA ASKUJT**

Ndoshta ditët e javës
I kanë ngatërruar itineraret.
E hëna
Asnjëherë nuk është e hënë,
Por një ditë asnjanëse
Në kalendarin e shënuar në mur.

Asnjë ditë më nuk qëndron
Në vendin e vet.
Janë  ngatërruar javët
Po ashtu edhe muajt
Viti më nuk është në vendin e vet.
Bredh rrugëve si lukunitë e tërbuara të qenve.

Kur mësova nga miqtë e mi
Për këto fenomene,
M'u dukën aq qesharake
Sa që nuk i besova askujt,
Se ditët, javët dhe muajt
Mund të ikin,
Si egërsirat nga kalendari i murit.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**NUK I BESOVA ASKUJT**

Ndoshta ditët e javës
I kanë ngatërruar itineraret.
E hëna
Asnjëherë nuk është e hënë,
Por një ditë asnjanëse
Në kalendarin e shënuar në mur.

Asnjë ditë më nuk qëndron
Në vendin e vet.
Janë  ngatërruar javët
Po ashtu edhe muajt
Viti më nuk është në vendin e vet.
Bredh rrugëve si lukunitë e tërbuara të qenve.

Kur mësova nga miqtë e mi
Për këto fenomene,
M'u dukën aq qesharake
Sa që nuk i besova askujt,
Se ditët, javët dhe muajt
Mund të ikin,
Si egërsirat nga kalendari i murit.

39

## NGA GJETHET FILLOI TË DERDHEJ STERRA

Dy flutura të bardha
Dhe dy njerëz,
U ulën në stolin e vjetër.
U ulën si kujtimet e parkut...

Era bisedonte me gjethet e fishkura,
Rigonte nga pak shtreza,
Një shi i përzier,
Me telat e këputura të kitarës.

Nga gjethet filloi të derdhej sterra...
Asnjë lule nuk mbeti
Në degët e blinit të vjetër,
Ikën edhe bletët në një tjetër koshere.

Vetëm rrënjët filluan të këndojnë
Një melodi të vjetër,
Apo ishin psalmet e fëmijërisë
Që i dëgjonim në Kishën e Shën Mërisë



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

NGA GJETHET FILLOI TË DERDHEJ STERRA

Dy flutura të bardha
Dhe dy njerëz,
U ulën në stolin e vjetër.
U ulën si kujtimet e parkut...

Era bisedonte me gjethet e fishkura,
Rigonte nga pak shtreza,
Një shi i përzier,
Me telat e këputura të kitarës.

Nga gjethet filloi të derdhej sterra...
Asnjë lule nuk mbeti
Në degët e blinit të vjetër,
Ikën edhe bletët në një tjetër koshere.

Vetëm rrënjët filluan të këndojnë
Një melodi të vjetër,
Apo ishin psalmet e fëmijërisë
Që i dëgjonim në Kishën e Shën Mërisë

40

## KUSH I THEU XHAMAT E SHIUT?!

Mbrëmë ishte ajo që trokiti
Në dritare me parathëniet e saja!
Po ju them se ishte ajo,
Sepse askush nuk di
Të trokasë kaq bukur
në dritaren time.

Nuk di, përse ju pyes juve,
Kur nuk jeni në gjendje t’i kuptoni
Të trokiturat e saj delikate?!

Ajo troket si pikat e shiut
Kur vjen te unë,
si freskia e pranverës.

Mos tentoni t'i thoni asnjë fjalë!
Ajo ishte te dritarja.
Vetëm gishtat e saj
janë në gjendje
Të lënë fërkema
Kaq delikate në shpirtin e xhamit të thyer.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

KUSH I THEU XHAMAT E SHIUT?!

Mbrëmë ishte ajo që trokiti
Në dritare me parathëniet e saja!
Po ju them se ishte ajo,
Sepse askush nuk di
Të trokasë kaq bukur
në dritaren time.

Nuk di, përse ju pyes juve,
Kur nuk jeni në gjendje t’i kuptoni
Të trokiturat e saj delikate?!

Ajo troket si pikat e shiut
Kur vjen te unë,
si freskia e pranverës.

Mos tentoni t'i thoni asnjë fjalë!
Ajo ishte te dritarja.
Vetëm gishtat e saj
janë në gjendje
Të lënë fërkema
Kaq delikate në shpirtin e xhamit të thyer.

41

Kush i theu xhamat e shiut?!
Era, apo hija e saj e imagjinuar?!

Ju lutem,
hapni dyert dhe dritaret
Për ata që trokasin kaq vonë
Në shpirtin tim të thyer dhe delikat!

Prishtinë, më 17 gusht,2018



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Kush i theu xhamat e shiut?!
Era, apo hija e saj e imagjinuar?!

Ju lutem,
hapni dyert dhe dritaret
Për ata që trokasin kaq vonë
Në shpirtin tim të thyer dhe delikat!

Prishtinë, më 17 gusht,2018

42

*Cikli i dytë*
*I dëgjuam disa britma të shurdhëta*



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

*Cikli i dytë*
*I dëgjuam disa britma të shurdhëta*

43

***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***


44

## MË KUJTOHET KUR ISHIM TË RINJ

Lëri kujtimet e tua
Në sirtarin e dhembjes!

Lëri me copëzat e jetës,
Askund nuk mund të shkosh,
As të bëhesh ushtarë i rrugëve!

Në qoftë se merr udhë,
Harroi monopatet e së kaluarës!
Ti je një tjetër njeri
Në vetvete,
Se për ndryshe s’kishe dalë në rrugë.

Më kujtohet,
 kur ishim të rinj,
Para nesh s’kishte asnjë kufi.

Pa i shëruar plagët
I kalonim malet e dhembjes,



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

MË KUJTOHET KUR ISHIM TË RINJ

Lëri kujtimet e tua
Në sirtarin e dhembjes!

Lëri me copëzat e jetës,
Askund nuk mund të shkosh,
As të bëhesh ushtarë i rrugëve!

Në qoftë se merr udhë,
Harroi monopatet e së kaluarës!
Ti je një tjetër njeri
Në vetvete,
Se për ndryshe s’kishe dalë në rrugë.

Më kujtohet,
 kur ishim të rinj,
Para nesh s’kishte asnjë kufi.

Pa i shëruar plagët
I kalonim malet e dhembjes,

45

I kalonim trishtimet e jetës.
Me një valixhe prej druri,
Disa letra dashurie në të,
Dhe një shami e lidhur si peng,
fshihnim lotët nënës,
fshinim edhe kujtimet e dhembjeve.

Ndërsa shkonim ushtarë,
Ishim të huaj në vendin tonë...

Të huajt komandonin,
se si duhet të flemë e të zgjohemi.
Kurse ne,
u ngjanim drurëve pa shpirt.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

I kalonim trishtimet e jetës.
Me një valixhe prej druri,
Disa letra dashurie në të,
Dhe një shami e lidhur si peng,
fshihnim lotët nënës,
fshinim edhe kujtimet e dhembjeve.

Ndërsa shkonim ushtarë,
Ishim të huaj në vendin tonë...

Të huajt komandonin,
se si duhet të flemë e të zgjohemi.
Kurse ne,
u ngjanim drurëve pa shpirt.

46

**I SHENJTI ULLI!**

Sa herë që ulem në kopshtin e kujtesës,
Dëgjoj  muzikën e lashtë të luleve.
Dëgjoj psalmet e fëmijërisë,
Dhe më përthekon një mall...

Më kapërthen,
si ajri i mëngjesit,
e kaluara.

Imazhet,
zbresin si perënditë...
Zbresin shkallëve të mendjes,
kujtimet.

Një aromë e mirë lozonjare
Miklon shpirtin e së kaluarës,
Si një muzikë,
miklon shqisat e të nuhaturit.

Me nostalgji,
drejtoj sytë kah pjergulla.
Kokrrat e rrushit m'i përkujtojnë ullinjtë,
në Kalanë e Krujës.

Ullirin e mbjellë nga dora e shenjtë,
Që mbante shpresën e shpatës së atdheut.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**I SHENJTI ULLI!**

Sa herë që ulem në kopshtin e kujtesës,
Dëgjoj  muzikën e lashtë të luleve.
Dëgjoj psalmet e fëmijërisë,
Dhe më përthekon një mall...

Më kapërthen,
si ajri i mëngjesit,
e kaluara.

Imazhet,
zbresin si perënditë...
Zbresin shkallëve të mendjes,
kujtimet.

Një aromë e mirë lozonjare
Miklon shpirtin e së kaluarës,
Si një muzikë,
miklon shqisat e të nuhaturit.

Me nostalgji,
drejtoj sytë kah pjergulla.
Kokrrat e rrushit m'i përkujtojnë ullinjtë,
në Kalanë e Krujës.

Ullirin e mbjellë nga dora e shenjtë,
Që mbante shpresën e shpatës së atdheut.

47

Më duket,
se viteve tetëdhjeta
të shekullit të kaluar,
bisedova me jehonën e rrënjëve të ullirit.

Për befasinë e të gjithëve,
M'u bë se dëgjoja zërin e Gjergjin tonë...



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Më duket,
se viteve tetëdhjeta
të shekullit të kaluar,
bisedova me jehonën e rrënjëve të ullirit.

Për befasinë e të gjithëve,
M'u bë se dëgjoja zërin e Gjergjin tonë...

48

## NATE LOTESH.

Nën ritmin e një ëndrre,
Dëgjoj një muzikë pagane.
Nga sytë e saj rrjedh,
si Drini i Bardhë në horizont,
një dritë inkandeshente.

Jashtë në oborr shiu nuk ka të ndalur.

Rigojnë disa stërkala lotësh
A thua vallë
Është duke dënesur qielli?!
Apo një tjetër lloj shiu,
Sivjet po bie në Fushën e Mëllenjave?!

Shikoj lart hapësira e errësuar
Duket si një flamur i grisur...
Asnjë yll i mirëfilltë
Nuk shihet në horizont.

Vdekja e akullt,
Sa shumë u ngjan sonte lotëve të nënave!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

NATE LOTESH.

Nën ritmin e një ëndrre,
Dëgjoj një muzikë pagane.
Nga sytë e saj rrjedh,
si Drini i Bardhë në horizont,
një dritë inkandeshente.

Jashtë në oborr shiu nuk ka të ndalur.

Rigojnë disa stërkala lotësh
A thua vallë
Është duke dënesur qielli?!
Apo një tjetër lloj shiu,
Sivjet po bie në Fushën e Mëllenjave?!

Shikoj lart hapësira e errësuar
Duket si një flamur i grisur...
Asnjë yll i mirëfilltë
Nuk shihet në horizont.

Vdekja e akullt,
Sa shumë u ngjan sonte lotëve të nënave!

49

Nën ritmin e një muzike,
 tërë melankoli,
Një zog i vetmuar fluturon
Nëpër vetminë e qiellit blu.

Ku mund të ketë kaltërsi të mirëfilltë
në këtë dhembje kaq të madhe?!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Nën ritmin e një muzike,
 tërë melankoli,
Një zog i vetmuar fluturon
Nëpër vetminë e qiellit blu.

Ku mund të ketë kaltërsi të mirëfilltë
në këtë dhembje kaq të madhe?!

50

**DUKEJ E LUMTUR**

Më kujtohet ajo,
dhe ëndrrat e saj.
Dielli ekzotik
Në unazën e pafajësisë
Dukej si një rreth imagjinar.

Flutura e verdhë,
mbase fluturonte
nëpër luadhet e kositura.
I donte shirat,
Ose ashtu kot,
vraponte pas ylberit

Njëherë në ditë dukej e trishtuar,
Kurse ditën tjetër,
luante valsin e lumturisë.
Luante nën tingujt e një muzike
Që nuk ka ekzistuar asnjëherë.

Edhe në atë gjendje
Jo të mirë shpirtërore,
Mund të luante me mjegullat,
Lojën e një kokëfortësie
në teatrin e qytetit.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

**DUKEJ E LUMTUR**

Më kujtohet ajo,
dhe ëndrrat e saj.
Dielli ekzotik
Në unazën e pafajësisë
Dukej si një rreth imagjinar.

Flutura e verdhë,
mbase fluturonte
nëpër luadhet e kositura.
I donte shirat,
Ose ashtu kot,
vraponte pas ylberit

Njëherë në ditë dukej e trishtuar,
Kurse ditën tjetër,
luante valsin e lumturisë.
Luante nën tingujt e një muzike
Që nuk ka ekzistuar asnjëherë.

Edhe në atë gjendje
Jo të mirë shpirtërore,
Mund të luante me mjegullat,
Lojën e një kokëfortësie
në teatrin e qytetit.

51

## POR EC E THYEJE TË KALUARËN

Në pasqyrën e madhe të korridorit,
Çdo mëngjes,
Duke i krehur flokët e thinjura,
Përshëndes vetveten,
Përshëndes njeriun
Që njiheshim para disa dekadave.

Ai thua se nuk u beson
Fjalëve të mija.

Me një qeshje gurgulluese
Me kthen përshëndetjen
Dhe sërish më shikon
me sytë e së kaluarës.

Isha dikush e diçka,
në kohën time,
Kur mund ta kafshoja hekurin,
Kurse sot nuk mundem
Të kafshoj as mollën e kalbur
Përpos t'i numëroj,
kah më shkunden thinjat.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

POR EC E THYEJE TË KALUARËN

Në pasqyrën e madhe të korridorit,
Çdo mëngjes,
Duke i krehur flokët e thinjura,
Përshëndes vetveten,
Përshëndes njeriun
Që njiheshim para disa dekadave.

Ai thua se nuk u beson
Fjalëve të mija.

Me një qeshje gurgulluese
Me kthen përshëndetjen
Dhe sërish më shikon
me sytë e së kaluarës.

Isha dikush e diçka,
në kohën time,
Kur mund ta kafshoja hekurin,
Kurse sot nuk mundem
Të kafshoj as mollën e kalbur
Përpos t'i numëroj,
kah më shkunden thinjat.

52

Me qindra herë desha ta thyej pasqyrën,
Ta thyej në qindra copëza kristalesh,

Por ec e thyeje të kaluarën,
Ajo as nuk thyhet
e as nuk përsëritet më
Me këtë shikim statuje
të ngrirë prej mermeri.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

Me qindra herë desha ta thyej pasqyrën,
Ta thyej në qindra copëza kristalesh,

Por ec e thyeje të kaluarën,
Ajo as nuk thyhet
e as nuk përsëritet më
Me këtë shikim statuje
të ngrirë prej mermeri.

53

**QANTE DHEU I ETËRVE**

Në zërin e lashtë të mermerit,
Dëgjohen vikamat e një kohe,
Dëgjohen disa piskama homerike.

Në fund të oborrit
Hapen dhe mbyllen portat e dyllta.

Një hije,
gjysmë e gjallë
e gjysmë e vdekur,
kalon vërdallë
nëpër kujtesën e brishtë të pemëve.
Disa kalimtarë i numërojnë arkivolet,
I numërojnë edhe të gjallët.

Sa pak njerëz paskan mbetur
Nga kjo luftë e padrejtë!
Sa shumë kuaj të plagosur
Hingëllijnë duke i kërkuar mëgojëzat!



*Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.*

**QANTE DHEU I ETËRVE**

Në zërin e lashtë të mermerit,
Dëgjohen vikamat e një kohe,
Dëgjohen disa piskama homerike.

Në fund të oborrit
Hapen dhe mbyllen portat e dyllta.

Një hije,
gjysmë e gjallë
e gjysmë e vdekur,
kalon vërdallë
nëpër kujtesën e brishtë të pemëve.
Disa kalimtarë i numërojnë arkivolet,
I numërojnë edhe të gjallët.

Sa pak njerëz paskan mbetur
Nga kjo luftë e padrejtë!
Sa shumë kuaj të plagosur
Hingëllijnë duke i kërkuar mëgojëzat!

54

Nën shalat e vdekura dikush i nxori flamujt...
Pakëz më vonë,
si nga honi,
I dëgjuam piskamat e nëntokës.

Qante dheu i etërve,
Qante fatin e luftës së padrejtë.

Dy kuaj të ngordhur
kundërmonin si plaga.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Nën shalat e vdekura dikush i nxori flamujt...
Pakëz më vonë,
si nga honi,
I dëgjuam piskamat e nëntokës.

Qante dheu i etërve,
Qante fatin e luftës së padrejtë.

Dy kuaj të ngordhur
kundërmonin si plaga.

55

**NË FSHAT NUK KISHTE MBETUR ASNJË QIVUR.**

Si zogjtë e sëmurë
Binin gjethet në tokë.
Vjeshta shkundej gjithandej,
Një stinë e pamëshirshme
Kishte zënë
të lëshonte rrënjë në fshatin tonë.

Më duket se ishte koha e errësirës.
Luftëtarët e rrugëve
Bridhnin prej një fshati në fshatin tjetër.
Bridhnin si hajdutët e natës.

I gjithë fshati ishte strukur
në lëkurën e gurit,
Korbat që gjendeshin nëpër çati
Mbase sollën murtajën
Nga një tjetër botë.
Njerëzit vdisnin si nëpër legjenda



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

**NË FSHAT NUK KISHTE MBETUR ASNJË QIVUR.**

Si zogjtë e sëmurë
Binin gjethet në tokë.
Vjeshta shkundej gjithandej,
Një stinë e pamëshirshme
Kishte zënë
të lëshonte rrënjë në fshatin tonë.

Më duket se ishte koha e errësirës.
Luftëtarët e rrugëve
Bridhnin prej një fshati në fshatin tjetër.
Bridhnin si hajdutët e natës.

I gjithë fshati ishte strukur
në lëkurën e gurit,
Korbat që gjendeshin nëpër çati
Mbase sollën murtajën
Nga një tjetër botë.
Njerëzit vdisnin si nëpër legjenda

56

Në fshat s'kishte mbetur asnjë qivur.
Po flitet se nga varret po ikin kufomat,
Largohen në një tjetër vend
Ose po iknin në botën tjetër,
Se kjo e jona
Sapo ka vdekur nga frika.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Në fshat s'kishte mbetur asnjë qivur.
Po flitet se nga varret po ikin kufomat,
Largohen në një tjetër vend
Ose po iknin në botën tjetër,
Se kjo e jona
Sapo ka vdekur nga frika.

57

## NËSE DUHET TË VDESËSH

Nëse duhet të vdesësh njeri,
Ti i ke dyert e hapura...
Në daç vdis nga turpi që
mban në shpirt,
Ose vdis si njeri
Për atdheun tënd të robëruar!

Kurrë më lehtë
Nuk e ke pasur në jetë,
Zgjedhja është jotja.

Ose vdis
si njeri me krenari,
Ose përfundo
si një kandër në gjiriz!

Nëse duhet të vdesësh,
Gjithmonë zgjidh të parën!
Nëse mendon për problemin e dytë,
Ti veç je i vdekur.
Një kufomë që e shpenzon ajrin e atdheut.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

NËSE DUHET TË VDESËSH

Nëse duhet të vdesësh njeri,
Ti i ke dyert e hapura...
Në daç vdis nga turpi që
mban në shpirt,
Ose vdis si njeri
Për atdheun tënd të robëruar!

Kurrë më lehtë
Nuk e ke pasur në jetë,
Zgjedhja është jotja.

Ose vdis
si njeri me krenari,
Ose përfundo
si një kandër në gjiriz!

Nëse duhet të vdesësh,
Gjithmonë zgjidh të parën!
Nëse mendon për problemin e dytë,
Ti veç je i vdekur.
Një kufomë që e shpenzon ajrin e atdheut.

58

Nëse duhet të jetosh,
Ti vdis si njeri!
Në të kundërtën varri yt,
Do të të pështyjë në fytyrë,
Posa të përfundon në rropullitë e tij.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Nëse duhet të jetosh,
Ti vdis si njeri!
Në të kundërtën varri yt,
Do të të pështyjë në fytyrë,
Posa të përfundon në rropullitë e tij.

59

**MË KUJTOHET VJESHTA E EGËR**

Dita nuk është dita e jote,
Nëse nuk i mban në mendje zërat.
Mund të jetosh edhe njëqind vjet,
Por zërin e erës
Kurrë mos e harro,
në daç që dita të jetë jotja!

Më kujtohet vjeshta e egër...
Kur binin gjethet në tokë,
Binin si kufomat në luftën e viteve të fundit.
Kurse njerëzit harronin
T'i mbajnë në mendje zërat.

Një mollë e këputur nga dega,
Nuk është fundi i botës,
Sepse nga ajo mollë e kalbur
Jetojnë përzgjedhësit e natyrës.
Që për mrekulli i mbajnë në mendje zërat.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

**MË KUJTOHET VJESHTA E EGËR**

Dita nuk është dita e jote,
Nëse nuk i mban në mendje zërat.
Mund të jetosh edhe njëqind vjet,
Por zërin e erës
Kurrë mos e harro,
në daç që dita të jetë jotja!

Më kujtohet vjeshta e egër...
Kur binin gjethet në tokë,
Binin si kufomat në luftën e viteve të fundit.
Kurse njerëzit harronin
T'i mbajnë në mendje zërat.

Një mollë e këputur nga dega,
Nuk është fundi i botës,
Sepse nga ajo mollë e kalbur
Jetojnë përzgjedhësit e natyrës.
Që për mrekulli i mbajnë në mendje zërat.

60

Shiko pra poet,
se si duhet të dukej
Pasqyre e një dite
Në telin e tretë të kitarës!

Duhet të dukej
 si zëri yt i shterur
Të cilin nuk e harron asnjëherë në jetë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Shiko pra poet,
se si duhet të dukej
Pasqyre e një dite
Në telin e tretë të kitarës!

Duhet të dukej
 si zëri yt i shterur
Të cilin nuk e harron asnjëherë në jetë.

61

## I DËGJUAM DISA BRITMA TË SHURDHËTA

Si një zë i përmbytur
Davaritet mjegulla e dendur.
Kambana sot nuk u dëgjua
Në fund të rrugës,
dëgjuam disa britma të shurdhëta.

Qante ikona e vjetër në murin e lagjes,
Qanin edhe gratë e peshkatarëve...

Një vajë trishtues
Dëgjuam në rrugën e kazanxhinjve.
Qanin me trishtim edhe qepenat!

Dielli thua se sot e kishte harruar
Itinerarin e përditshëm.
Disi kalonte
Nëpër skutat e lagjeve të varfra.
Mbase dukej më krenar për ekuinoksin.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

I DËGJUAM DISA BRITMA TË SHURDHËTA

Si një zë i përmbytur
Davaritet mjegulla e dendur.
Kambana sot nuk u dëgjua
Në fund të rrugës,
dëgjuam disa britma të shurdhëta.

Qante ikona e vjetër në murin e lagjes,
Qanin edhe gratë e peshkatarëve...

Një vajë trishtues
Dëgjuam në rrugën e kazanxhinjve.
Qanin me trishtim edhe qepenat!

Dielli thua se sot e kishte harruar
Itinerarin e përditshëm.
Disi kalonte
Nëpër skutat e lagjeve të varfra.
Mbase dukej më krenar për ekuinoksin.

62

## PO KUSH I DËGJOI LUTJET E MIA

Ishte një kohë,
kur nuk i besova askujt.
Kujt t'i besoj?!
Që të gjithë më gënjejnë,
E humba besimin,
Por edhe zotave më,
nuk desha t'u lutem!

Kot jam lutur mbi shtatë dekada,
Po kush i dëgjoi hallet e mia?!

Më duket se qeshnin
Me pamaturinë time.
U lutu si kurrë në jetë,
e kujt nuk iu luta?

Askush, asnjëherë
Nuk i përfillte lutjet e mia!

Ja pra, kështu siç jam
Arrita në fund të rrugës.
Edhe në këtë gjendje latente,
S'dua t'i lutem askujt!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

PO KUSH I DËGJOI LUTJET E MIA

Ishte një kohë,
kur nuk i besova askujt.
Kujt t'i besoj?!
Që të gjithë më gënjejnë,
E humba besimin,
Por edhe zotave më,
nuk desha t'u lutem!

Kot jam lutur mbi shtatë dekada,
Po kush i dëgjoi hallet e mia?!

Më duket se qeshnin
Me pamaturinë time.
U lutu si kurrë në jetë,
e kujt nuk iu luta?

Askush, asnjëherë
Nuk i përfillte lutjet e mia!

Ja pra, kështu siç jam
Arrita në fund të rrugës.
Edhe në këtë gjendje latente,
S'dua t'i lutem askujt!

63

Më duket se
Kanë vdekur zotat e mi paganë.
Kurse këta të sotme
Mbase të shurdhët janë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Më duket se
Kanë vdekur zotat e mi paganë.
Kurse këta të sotme
Mbase të shurdhët janë.

64

## NË MESIN E SHUMË FYTYRAVE

Ajo duke bartur peshën e viteve,
Kalon e kërrusur
Nëpër trotuaret e zhubrosura.

Si fytyra,
ashtu dhe kurrizi i saj,
Kalon e vetmuar
Me ëndrrën e një të urituri.

Është një fytyrë e panjohur
Në mesin
E qindra fytyrave të ngjashme.

Protagonistja e Migjenit,
Apo i ndonjë poeti tjetër klasik,
Por ajo kalon e ngarkuar
Me vitet e saj nëpër rrugët e urisë.



***<u>Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.</u>***

NË MESIN E SHUMË FYTYRAVE

Ajo duke bartur peshën e viteve,
Kalon e kërrusur
Nëpër trotuaret e zhubrosura.

Si fytyra,
ashtu dhe kurrizi i saj,
Kalon e vetmuar
Me ëndrrën e një të urituri.

Është një fytyrë e panjohur
Në mesin
E qindra fytyrave të ngjashme.

Protagonistja e Migjenit,
Apo i ndonjë poeti tjetër klasik,
Por ajo kalon e ngarkuar
Me vitet e saj nëpër rrugët e urisë.

65

Gjithsesi nuk janë të vetmet...
Ka edhe burra që bredhin rrugëve
Për të gjetur
Një kafshatë të mykur buke.
Në ndonjë kontejner
Te i cili e zë dhe gjumi.

Kurse mëngjeseve herët
Zgjohen edhe më të uritur se ç'ishin...



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Gjithsesi nuk janë të vetmet...
Ka edhe burra që bredhin rrugëve
Për të gjetur
Një kafshatë të mykur buke.
Në ndonjë kontejner
Te i cili e zë dhe gjumi.

Kurse mëngjeseve herët
Zgjohen edhe më të uritur se ç'ishin...

66

**FJETËM AQ MIRË ATË NATË**

Në tregun e plaçkave,
Bleva disa bukë të mykura,
Bajate.
Sa që t'i thyejnë dhëmbët.

Nuk kisha aq shumë lek,
Të blija aromën e bukës së pjekur.

Dielli atë ditë,
dukej tepër lart...
Aq lart,
Sa që nuk ishim në gjendje të piqnim brumin
e dhuruar,
nga fqinjët e kamur.

Asnjë shkarpë druri
Nuk na kishte mbetur në shtëpi.

Ishim në një dilemë hamletiane:
"Të jesh, apo të mos jesh!"



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

**FJETËM AQ MIRË ATË NATË**

Në tregun e plaçkave,
Bleva disa bukë të mykura,
Bajate.
Sa që t'i thyejnë dhëmbët.

Nuk kisha aq shumë lek,
Të blija aromën e bukës së pjekur.

Dielli atë ditë,
dukej tepër lart...
Aq lart,
Sa që nuk ishim në gjendje të piqnim brumin
e dhuruar,
nga fqinjët e kamur.

Asnjë shkarpë druri
Nuk na kishte mbetur në shtëpi.

Ishim në një dilemë hamletiane:
"Të jesh, apo të mos jesh!"

67

I mbyllëm sytë,
dhe i kapërdimë kafshatat e brumit.

Fjetëm aq mirë atë natë
Sa që harruam të zgjoheshim të nesërmen



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

I mbyllëm sytë,
dhe i kapërdimë kafshatat e brumit.

Fjetëm aq mirë atë natë
Sa që harruam të zgjoheshim të nesërmen

68

**DILEMA**

Ne jemi secili nga një pjesë
E huazuar në vetvete.

I shikojmë duart tona,
dhe nuk besojmë se,
i përkasin
Gjymtyrëve të ndonjë peme të shartuar.

Sa herë që desha të jem vetvetja,
Njëqind pengesa
Më dilnin parasysh.

Fillonte përsëri një tjetër dilemë:
"Jam apo nuk jam unë në lëkurën tënde?!"

Më thënien e Hamletit u bëmë përrallë,
Tani me kjo dilemë
"Të jesh apo të mos jesh!"
Është më mirë kjo e dyta
Të mos jesh!
Sepse e para e ka humbur kuptimin e vetë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**DILEMA**

Ne jemi secili nga një pjesë
E huazuar në vetvete.

I shikojmë duart tona,
dhe nuk besojmë se,
i përkasin
Gjymtyrëve të ndonjë peme të shartuar.

Sa herë që desha të jem vetvetja,
Njëqind pengesa
Më dilnin parasysh.

Fillonte përsëri një tjetër dilemë:
"Jam apo nuk jam unë në lëkurën tënde?!"

Më thënien e Hamletit u bëmë përrallë,
Tani me kjo dilemë
"Të jesh apo të mos jesh!"
Është më mirë kjo e dyta
Të mos jesh!
Sepse e para e ka humbur kuptimin e vetë.

69

## TI SHNDËRROHESH NË NJË ZAMBAK

Nuk di,
kam shumë dilema parasysh.
Si mund të të krahasoj me erën?!
Një ditë je grua,
Kurse ditën tjetër enigmë
E cila nuk zgjidhet me kashelasha.

Të pata thënë dikur moti,
Se kur shpërfaqet agullima
Në liqenin e bardhë të kujtesës,
Ti shndërrohesh në një zambak.
Sytë e tua huazojnë ngjyrat nga ylberi.

Ti nuk je as grua e as peri,
Je një enigmë
E pazgjidhur ndër shekuj.

Të ishe ti grua,
unë do isha burrë
Por tani s’di se çfarë jam më.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

TI SHNDËRROHESH NË NJË ZAMBAK

Nuk di,
kam shumë dilema parasysh.
Si mund të të krahasoj me erën?!
Një ditë je grua,
Kurse ditën tjetër enigmë
E cila nuk zgjidhet me kashelasha.

Të pata thënë dikur moti,
Se kur shpërfaqet agullima
Në liqenin e bardhë të kujtesës,
Ti shndërrohesh në një zambak.
Sytë e tua huazojnë ngjyrat nga ylberi.

Ti nuk je as grua e as peri,
Je një enigmë
E pazgjidhur ndër shekuj.

Të ishe ti grua,
unë do isha burrë
Por tani s’di se çfarë jam më.

70

Të pyeta,
je grua apo enigmë?

Nëse je enigmë,
Të lutem, m'i sill sonte çelësat
T'i hap njëherë e përgjithmonë
Të gjitha portat e mbyllura të mjegullave.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Të pyeta,
je grua apo enigmë?

Nëse je enigmë,
Të lutem, m'i sill sonte çelësat
T'i hap njëherë e përgjithmonë
Të gjitha portat e mbyllura të mjegullave.

71

## NGA RRËNJËT E TYRE PREJ PUTHJEVE

Lulet e këtij kopshti të mistershëm,
Nuk janë për askënd,
As për të vdekurit.
Kanë një aromë të ngjashëm me naftalinën.
Mbase janë ujitur me vajguri!

Sa herë që vdes ndonjë qytetarë,
Askush nuk blen lule nga ky kopsht.

Ju tregova
Se këto lule nuk u përkasin të vdekurve
Vetëm të gjallët
Mund të kalojnë këndej.

Thashë se vetëm mund të kalojnë,
E jo t'i prekin
Me duart e tyre të zhubrosura.
Po i , preku dikush rastësisht,



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

NGA RRËNJËT E TYRE PREJ PUTHJEVE

Lulet e këtij kopshti të mistershëm,
Nuk janë për askënd,
As për të vdekurit.
Kanë një aromë të ngjashëm me naftalinën.
Mbase janë ujitur me vajguri!

Sa herë që vdes ndonjë qytetarë,
Askush nuk blen lule nga ky kopsht.

Ju tregova
Se këto lule nuk u përkasin të vdekurve
Vetëm të gjallët
Mund të kalojnë këndej.

Thashë se vetëm mund të kalojnë,
E jo t'i prekin
Me duart e tyre të zhubrosura.
Po i , preku dikush rastësisht,

72

Ato, nga secila prekje,
veniten
Dhe kurrë më nuk çelin lule prej guri.

Lulet e këtij kopshti që rriten mes gurëve,
Rrënjët i kanë prej mermeri
Sa herë që çelin petale të bardha.
Çuditërisht
I çelin lulet më të bukura
Nga rrënjët e tyre prej puthjeve.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Ato, nga secila prekje,
veniten
Dhe kurrë më nuk çelin lule prej guri.

Lulet e këtij kopshti që rriten mes gurëve,
Rrënjët i kanë prej mermeri
Sa herë që çelin petale të bardha.
Çuditërisht
I çelin lulet më të bukura
Nga rrënjët e tyre prej puthjeve.

73

## FILLON AVAZI PARAPRAK I DIMRIT

Nuk është lehtë të jesh pemë,
E cila çel lule vetëm kur vjen dimri.
Por ja që edhe pemët
Janë të mistershme si njerëzit.
Kurrë nuk u dihet gjetheve
Se në cilën kohë shpërthejnë
Sythat e blerta të luleve.

Këtu në atdheun tim,
Dimrat janë me shumë fshehtësi.

Ditët dënesin,
kur bie borë,
Kurse netët e gjata
Duken te hareshme.
Dhe gjatë tërë kohës këndojnë
Psalmet e bukura të yjeve.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

FILLON AVAZI PARAPRAK I DIMRIT

Nuk është lehtë të jesh pemë,
E cila çel lule vetëm kur vjen dimri.
Por ja që edhe pemët
Janë të mistershme si njerëzit.
Kurrë nuk u dihet gjetheve
Se në cilën kohë shpërthejnë
Sythat e blerta të luleve.

Këtu në atdheun tim,
Dimrat janë me shumë fshehtësi.

Ditët dënesin,
kur bie borë,
Kurse netët e gjata
Duken te hareshme.
Dhe gjatë tërë kohës këndojnë
Psalmet e bukura të yjeve.

74

Pastaj në mëngjes pa zbritur gjeli
Nga trarët e çatisë gjysmë të rrënuar,
Për treqind e gjashtëdhjetë shkallë,
Ndryshon moti i egër.

Dikur vonë pas dite
Kur këndesat hipin nëpër trarët e çative
Fillon avazi paraprak i dimrit.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Pastaj në mëngjes pa zbritur gjeli
Nga trarët e çatisë gjysmë të rrënuar,
Për treqind e gjashtëdhjetë shkallë,
Ndryshon moti i egër.

Dikur vonë pas dite
Kur këndesat hipin nëpër trarët e çative
Fillon avazi paraprak i dimrit.

75

## NJË GOTË KËNAQËSIE

Po ju them se njeriu është
Një kokërr pluhuri
Përzier me lotin e Krishtit.
Sa herë që qan era,
Hapen portat e parajsës për mëkatarët.

Ata që nuk dinë të mëkatojnë,
S'dinë as të falin.

Në një gotë të kristaltë vere,
Derdhet si përrua,
Gjaku i pangjyrë i njeriut.

Kur zgjohemi në mëngjes,
Mbase këndesi shumë më herët
E ka zgjuar mëngjesin,
Kurse edhe ne
Zgjohemi si delet e dehura.



*Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.*

NJË GOTË KËNAQËSIE

Po ju them se njeriu është
Një kokërr pluhuri
Përzier me lotin e Krishtit.
Sa herë që qan era,
Hapen portat e parajsës për mëkatarët.

Ata që nuk dinë të mëkatojnë,
S'dinë as të falin.

Në një gotë të kristaltë vere,
Derdhet si përrua,
Gjaku i pangjyrë i njeriut.

Kur zgjohemi në mëngjes,
Mbase këndesi shumë më herët
E ka zgjuar mëngjesin,
Kurse edhe ne
Zgjohemi si delet e dehura.

76

Ndoshta bariu i tufës
Ishte dehur aq shumë,
Sa që u lejoi edhe deleve
Nga një gotë kënaqësie.
Që të këndellen më esëll në mëngjes.

Retë ngjyrë katrani,
i kishin zënë frymëmarrjen qiellit.

Një muzikë lashtë,
Vdiste ngadalë,
Pasi u zhduk ekuinoksi,
Mjegullat filluan ta ndryshojnë ngjyrën.

Ishte dita, kur pritnim shiun e pranverës,
Pritnim si puthjet e para
Në adoleshencë,
Kurse papritmas ia behën
Kalorësit e egër të Apokalipsit.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Ndoshta bariu i tufës
Ishte dehur aq shumë,
Sa që u lejoi edhe deleve
Nga një gotë kënaqësie.
Që të këndellen më esëll në mëngjes.

Retë ngjyrë katrani,
i kishin zënë frymëmarrjen qiellit.

Një muzikë lashtë,
Vdiste ngadalë,
Pasi u zhduk ekuinoksi,
Mjegullat filluan ta ndryshojnë ngjyrën.

Ishte dita, kur pritnim shiun e pranverës,
Pritnim si puthjet e para
Në adoleshencë,
Kurse papritmas ia behën
Kalorësit e egër të Apokalipsit.

77

Ja behën me nga pesë kuaj të çmendur.
Hëna kishte ikur deri atje
Ku e bëjnë gjumin zanat
Ku gjithmonë rrinë të zgjuara legjendat.
Një mot i lig tërë trishtim
E mbuloi qytetin me qulla kuajsh.
Brenda portave s’dëgjohej asnjë zë njeriu.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Ja behën me nga pesë kuaj të çmendur.
Hëna kishte ikur deri atje
Ku e bëjnë gjumin zanat
Ku gjithmonë rrinë të zgjuara legjendat.
Një mot i lig tërë trishtim
E mbuloi qytetin me qulla kuajsh.
Brenda portave s’dëgjohej asnjë zë njeriu.

78

**UNË DI QË TI NUK I DO SHIRAT**

Kur ti je i lodhur,
Në tëmtha ndjen shtrëngime muskujsh,
Ti sërish je po ai njeri
Me vetveten tënde të zvogëluar
Mundohesh t'i thyesh pasqyrat në korridor.

Nuk është hera e parë
Që jam duke të të tërhequr vërejtjen.
Shiko në pasqyrën e thyer
Se sa shumë të janë skuqur sytë.
Mbase nga verbëria,
nuk sheh asgjë

Sa shumë ka dritë ky korridor i madh,
E sa pak sheh.

Shiko më mirë pasqyrën e thyer!
Shiko si të xhelozojnë ciflat
E kristalta të gotës së dehur nga dhembja!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**UNË DI QË TI NUK I DO SHIRAT**

Kur ti je i lodhur,
Në tëmtha ndjen shtrëngime muskujsh,
Ti sërish je po ai njeri
Me vetveten tënde të zvogëluar
Mundohesh t'i thyesh pasqyrat në korridor.

Nuk është hera e parë
Që jam duke të të tërhequr vërejtjen.
Shiko në pasqyrën e thyer
Se sa shumë të janë skuqur sytë.
Mbase nga verbëria,
nuk sheh asgjë

Sa shumë ka dritë ky korridor i madh,
E sa pak sheh.

Shiko më mirë pasqyrën e thyer!
Shiko si të xhelozojnë ciflat
E kristalta të gotës së dehur nga dhembja!

79

Nuk biseduam kot për të reshurat.
Unë e di,
që ti nuk i do shirat...
Në gjeografinë e shpirtit tënd
Rritet vetëm ajo pemë që s’di gjë tjetër
Përpos të çeli urrejtje brenda katër stinëve



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Nuk biseduam kot për të reshurat.
Unë e di,
që ti nuk i do shirat...
Në gjeografinë e shpirtit tënd
Rritet vetëm ajo pemë që s’di gjë tjetër
Përpos të çeli urrejtje brenda katër stinëve

80

## NJË DITË E NJË KOHË

Kur zgjohet shtrëngata,
Zogjtë e egër nuk ikin nga njerëzit,
Por nga vetvetja.
Ashtu siç ikim edhe ne,
Nga një stuhi e rrëmbyeshme e shpirtit.

Ku të vijmë në këtë kohë
Të papërshtatshme për fluturat,
Do mbesim krijesa pa gjymtyrë,
Sapo i hapim duart
Do e prekim ajrin e tendosur të rrymës

Një ditë domosdo,
do takohemi me vetveten,
Ashtu siç takohen zogjtë
Me dendësinë e mjegullave.

Vetëm retë dhe vetëtimat
Do na mbajnë peng
Të mos fluturojmë përtej vetvetes.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

NJË DITË E NJË KOHË

Kur zgjohet shtrëngata,
Zogjtë e egër nuk ikin nga njerëzit,
Por nga vetvetja.
Ashtu siç ikim edhe ne,
Nga një stuhi e rrëmbyeshme e shpirtit.

Ku të vijmë në këtë kohë
Të papërshtatshme për fluturat,
Do mbesim krijesa pa gjymtyrë,
Sapo i hapim duart
Do e prekim ajrin e tendosur të rrymës

Një ditë domosdo,
do takohemi me vetveten,
Ashtu siç takohen zogjtë
Me dendësinë e mjegullave.

Vetëm retë dhe vetëtimat
Do na mbajnë peng
Të mos fluturojmë përtej vetvetes.

81

Një ditë e në një kohë
Kur më nuk kemi
Se çfarë të humbim
Nëpër xhepat e grisura të erës
Do i kërkojmë lutjet tona
Të pa kënduara.
Për askënd dhe asnjëherë!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Një ditë e në një kohë
Kur më nuk kemi
Se çfarë të humbim
Nëpër xhepat e grisura të erës
Do i kërkojmë lutjet tona
Të pa kënduara.
Për askënd dhe asnjëherë!

82

## ASNJËHERË NUK NA NDIHMUAN SHTËRGJET

Është koha e një kohe
Të cilën jemi duke pritur
Me qindra vite.
Por ja ,
që ende nuk erdhi,
Kishte humbur në fushën e mistereve.

Ne, në mendjet tona
Nuk lëmë shteg pa kaluar...
Derisa arrijmë të takohemi me kohën,
Por fati s’deshi që t’i bashkojmë
Rrënjët e rrapit me ato të barit.

Nuk di për sa kohë humbëm kohë,
Por ne mbetëm peng
i pritjeve dhe thirrjeve tona.
Kurrë nuk na ndihmuan shtërgjet
Ta gjejmë itinerarin për në atdhe.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

ASNJËHERË NUK NA NDIHMUAN SHTËRGJET

Është koha e një kohe
Të cilën jemi duke pritur
Me qindra vite.
Por ja ,
që ende nuk erdhi,
Kishte humbur në fushën e mistereve.

Ne, në mendjet tona
Nuk lëmë shteg pa kaluar...
Derisa arrijmë të takohemi me kohën,
Por fati s’deshi që t’i bashkojmë
Rrënjët e rrapit me ato të barit.

Nuk di për sa kohë humbëm kohë,
Por ne mbetëm peng
i pritjeve dhe thirrjeve tona.
Kurrë nuk na ndihmuan shtërgjet
Ta gjejmë itinerarin për në atdhe.

83

**U FRIKËSOHESHA KËNDESAVE.**

Ajo ishte frymëmarrja e kopshtit,
Çdo mëngjes përcillte
Rritjen e pemëve,
Përcillte orë e çast
Ndryshimin e kokrrave të klorofilit.

Ju tregova se ajo ishte
Alfa dhe omega e çdo gjëje,
Që fillonte të lulëzojë.

Në puthjet e saj të brishta,
Gjithmonë çelte më herët pranvera.

Më kujtohet,
kur u takuam
Për herë të parë.

Ishte një dimër i acartë,
Ndoshta edhe nuk ishte dimër,
Por unë e kisha gjuhën e ngrirë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**U FRIKËSOHESHA KËNDESAVE.**

Ajo ishte frymëmarrja e kopshtit,
Çdo mëngjes përcillte
Rritjen e pemëve,
Përcillte orë e çast
Ndryshimin e kokrrave të klorofilit.

Ju tregova se ajo ishte
Alfa dhe omega e çdo gjëje,
Që fillonte të lulëzojë.

Në puthjet e saj të brishta,
Gjithmonë çelte më herët pranvera.

Më kujtohet,
kur u takuam
Për herë të parë.

Ishte një dimër i acartë,
Ndoshta edhe nuk ishte dimër,
Por unë e kisha gjuhën e ngrirë.

84

S’kisha guxim të them asnjë fjalë,
Aq i vogël dukesha para syve të saj,
Sa që u frikësohesha këndesave
Të mos më përpinin
Në vend të kokrrës së melit.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

S’kisha guxim të them asnjë fjalë,
Aq i vogël dukesha para syve të saj,
Sa që u frikësohesha këndesave
Të mos më përpinin
Në vend të kokrrës së melit.

85

## TAKOHEMI DIKU NË FILLIM

Në jetë kemi me qindra çaste
Të trishtuara....
Dhe ato më sublime,
Jetojmë për një tufë zambakësh të bardhë.
Dhe fluturimin e dallëndyshes në kujtesë.

Kur takohemi diku në fillim,
Ose në fund të rrugës me vetveten,
zgjasim duart tona në drejtim të pasqyrës,
Jo për ta thyer,
Por për ta përqafuan siluetën tonë.

Më pastaj,
nëse pendohemi
për gabimet tona,
Ose për ato të bëma,
që nuk i bëmë,
Harrojmë të kërkojmë falje
Për mëkatet që na presin diku.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

TAKOHEMI DIKU NË FILLIM

Në jetë kemi me qindra çaste
Të trishtuara....
Dhe ato më sublime,
Jetojmë për një tufë zambakësh të bardhë.
Dhe fluturimin e dallëndyshes në kujtesë.

Kur takohemi diku në fillim,
Ose në fund të rrugës me vetveten,
zgjasim duart tona në drejtim të pasqyrës,
Jo për ta thyer,
Por për ta përqafuan siluetën tonë.

Më pastaj,
nëse pendohemi
për gabimet tona,
Ose për ato të bëma,
që nuk i bëmë,
Harrojmë të kërkojmë falje
Për mëkatet që na presin diku.

86

Kur na kujtohen pas një kohe,
Të gjitha ato çaste sublime
Për asgjë tjetër nuk pendohemi,
Përpos që na mundon një pyetje:
A thua vallë ditëm t'i përballojmë si duhet?!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Kur na kujtohen pas një kohe,
Të gjitha ato çaste sublime
Për asgjë tjetër nuk pendohemi,
Përpos që na mundon një pyetje:
A thua vallë ditëm t'i përballojmë si duhet?!

87

**POR TI KURRË MOS U BEFASO**

Para nesh te ato imazhe
Na presin në horizontin
E kaltër;
-Dy dete fjalësh,
-Tri dete trishtimesh,
-E shtatë dete puthjesh...

Ki kujdes,
Mos shkel asnjëherë
Mbi zambakët e bardhë!
Sepse po shkele,
Në shijen e ujit të njelmët
Do venitet ngjyra e puthjeve.

Të thashë,
se para nesh,
Në horizont
Na presin disa lloje befasish.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**POR TI KURRË MOS U BEFASO**

Para nesh te ato imazhe
Na presin në horizontin
E kaltër;
-Dy dete fjalësh,
-Tri dete trishtimesh,
-E shtatë dete puthjesh...

Ki kujdes,
Mos shkel asnjëherë
Mbi zambakët e bardhë!
Sepse po shkele,
Në shijen e ujit të njelmët
Do venitet ngjyra e puthjeve.

Të thashë,
se para nesh,
Në horizont
Na presin disa lloje befasish.

88

Por ti kurrë mos u befaso,
Nëse e prekim tërfilin
Me katër gjethe,
Sepse në brendinë e tij
I kemi lënë peng puthjet tona!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Por ti kurrë mos u befaso,
Nëse e prekim tërfilin
Me katër gjethe,
Sepse në brendinë e tij
I kemi lënë peng puthjet tona!

89

**PATJETËR DO TË TRIUMFOJË!**

Kur lodhem nga vetvetja,
Shikoj në drejtim të horizontit.

Mos vallë
Do gjej një  tjetër tokë të re
Ku mund të banoj,
pa frikë nga askush

Gjithmonë më ka munguar
Hapësira në gjetjen e tokës së lirë.
Ku askush,
askujt nuk i pengon,
Por me një prekje sublime
Të pranon si mikun e vjetër të fëmijërisë.

Ah, ku mund ta gjej një tokë të tillë?!
Ku?
Nëpër pemët e egra,
Gjethet çelin dashuri
Kurse dashuria me miliona puthje
Në buzët e pa puthura të yjeve.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**PATJETËR DO TË TRIUMFOJË!**

Kur lodhem nga vetvetja,
Shikoj në drejtim të horizontit.

Mos vallë
Do gjej një  tjetër tokë të re
Ku mund të banoj,
pa frikë nga askush

Gjithmonë më ka munguar
Hapësira në gjetjen e tokës së lirë.
Ku askush,
askujt nuk i pengon,
Por me një prekje sublime
Të pranon si mikun e vjetër të fëmijërisë.

Ah, ku mund ta gjej një tokë të tillë?!
Ku?
Nëpër pemët e egra,
Gjethet çelin dashuri
Kurse dashuria me miliona puthje
Në buzët e pa puthura të yjeve.

90

Jam shumë i sigurt,
Se nuk trokas kot në dyert e qiellit.
Një ditë do hapen,
domosdo do hapen,
Sepse dashuria njerëzore
Patjetër do triumfojë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Jam shumë i sigurt,
Se nuk trokas kot në dyert e qiellit.
Një ditë do hapen,
domosdo do hapen,
Sepse dashuria njerëzore
Patjetër do triumfojë.

91

## POR LUTJET ISHIN TË KOTA

Kur mbetesh vetëm,
I harron edhe lutjet e përditshmërisë.

Harron,
kush ishe dje,
Çfarë bën tani
Dhe mund të jesh sot.

Më kujtohet,
kur u gjenda njëherë
Në tokën e huaj.
Ishte një trishtim shpirtëror
Të shikosh vetveten
Duke vdekur ngadalë.

Nuk isha në gjendje
Të bëj më asnjë lëvizje,
Më dridheshin duart
Si flokët e elektrizuar nga frika,
Më dridhej, si purtek ashti kurrizor.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

POR LUTJET ISHIN TË KOTA

Kur mbetesh vetëm,
I harron edhe lutjet e përditshmërisë.

Harron,
kush ishe dje,
Çfarë bën tani
Dhe mund të jesh sot.

Më kujtohet,
kur u gjenda njëherë
Në tokën e huaj.
Ishte një trishtim shpirtëror
Të shikosh vetveten
Duke vdekur ngadalë.

Nuk isha në gjendje
Të bëj më asnjë lëvizje,
Më dridheshin duart
Si flokët e elektrizuar nga frika,
Më dridhej, si purtek ashti kurrizor.

92

Desha të kërkoj ndihmë,
T'i lutem Zotit ose perëndive pagan,
Por lutjet ishin të kota.

Shurdhmemecët e mallkuar
Kurrë nuk më dëgjuan asnjëherë!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Desha të kërkoj ndihmë,
T'i lutem Zotit ose perëndive pagan,
Por lutjet ishin të kota.

Shurdhmemecët e mallkuar
Kurrë nuk më dëgjuan asnjëherë!

93

## ATDHEU IM ISHTE NJË TOKË PA DIELL

Atdheu im,
nuk kishte diell
Nën të cilin mund të dashuronim.

Puthjet i kishim të frikshme,
Fshiheshim pas një hëne,
E cila kurrë nuk ishte e sigurt.

Më kujtohet puthja e parë,
E cila  u paraqit si ekuinoksi.
Iku me lindjen e diellit,
Iku para se të kuptonin  të afërmit.
Shijen e parë të fluturimit të dallëndyshes.



***Kush i theu xhamat e shiut  Adem .Z.***

ATDHEU IM ISHTE NJË TOKË PA DIELL

Atdheu im,
nuk kishte diell
Nën të cilin mund të dashuronim.

Puthjet i kishim të frikshme,
Fshiheshim pas një hëne,
E cila kurrë nuk ishte e sigurt.

Më kujtohet puthja e parë,
E cila  u paraqit si ekuinoksi.
Iku me lindjen e diellit,
Iku para se të kuptonin  të afërmit.
Shijen e parë të fluturimit të dallëndyshes.

94

Ishin kohërat,
kur duhej të fshiheshim
Nga shteti i huaj.
Dhe nga pushteti i familjes
Ku të puthesh,
kur në atdheun tënd
Binin plumbat si shirat e vjeshtës

Atdheu im ishte një tokë pa diell,
Hëna e ngrirë
Mbrëmjeve të vona,
Dukej si një top i kristaltë prej bore.
Ec e puthu me të papriturën e befasishme!



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

Ishin kohërat,
kur duhej të fshiheshim
Nga shteti i huaj.
Dhe nga pushteti i familjes
Ku të puthesh,
kur në atdheun tënd
Binin plumbat si shirat e vjeshtës

Atdheu im ishte një tokë pa diell,
Hëna e ngrirë
Mbrëmjeve të vona,
Dukej si një top i kristaltë prej bore.
Ec e puthu me të papriturën e befasishme!

95

## I KA SHTAË PALË SY

Po qe se deti nuk ka asnjë emër,
Ngjitja emrin tënd,
Ose thirre si të duash!

Kryesore të kuptohemi si duhet,
Secili ta mësojë gjuhën e njëri-tjetrit.

Nëse çastet i ngjajnë fjalës,
Fol një fjalë o burrë,
Mos ngurro!

Meduzat janë në gjendje
Ta kuptojnë dashurinë tënde.

Fol, thirre në emër!
Ose ngjitja një emër të mirë,
Do të të kuptoj,
Më mirë se sa ti e kupton vetveten,
Thirre si të duash,
deti ka shpirt!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

I KA SHTAË PALË SY

Po qe se deti nuk ka asnjë emër,
Ngjitja emrin tënd,
Ose thirre si të duash!

Kryesore të kuptohemi si duhet,
Secili ta mësojë gjuhën e njëri-tjetrit.

Nëse çastet i ngjajnë fjalës,
Fol një fjalë o burrë,
Mos ngurro!

Meduzat janë në gjendje
Ta kuptojnë dashurinë tënde.

Fol, thirre në emër!
Ose ngjitja një emër të mirë,
Do të të kuptoj,
Më mirë se sa ti e kupton vetveten,
Thirre si të duash,
deti ka shpirt!

96

Po qe se nuk të kupton,
Kuptoje ti detin,
Sepse dashuria nuk është e verbër,
I ka shtatë palë sy,
Fare mirë e kupton dashurinë tënde.
Prishtinë, 19 gusht 2018.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Po qe se nuk të kupton,
Kuptoje ti detin,
Sepse dashuria nuk është e verbër,
I ka shtatë palë sy,
Fare mirë e kupton dashurinë tënde.
Prishtinë, 19 gusht 2018.

97

Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.



98

*Cikli i tretë*
*"Gatuam emrin e atdheut tim"*



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

*Cikli i tretë*
*"Gatuam emrin e atdheut tim"*

99

Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.

100

**PËR HERONJTË DHE MASKARENJTË**

Do ishte mrekullia
e mrekullisë,
Sikur të kishin sy dhe vesh
Lagështit e kësaj qelie.
Do më tregonin për çdo gjë
Që ka ndodhur
Mes katër mureve të betonta.

Do tregonin,
për trimëritë e tradhtitë
E të burgosurve.

Do i dëgjoja në ankth
Piskamat e trishtuara.

Por ja që kanë qëlluar
Shurdhmemece,
Pa gojë e sy,
Vesh dhe gjuhë
Andaj s'tregojnë asnjë fjalë,
Për heronjtë dhe maskarenjtë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**PËR HERONJTË DHE MASKARENJTË**

Do ishte mrekullia
e mrekullisë,
Sikur të kishin sy dhe vesh
Lagështit e kësaj qelie.
Do më tregonin për çdo gjë
Që ka ndodhur
Mes katër mureve të betonta.

Do tregonin,
për trimëritë e tradhtitë
E të burgosurve.

Do i dëgjoja në ankth
Piskamat e trishtuara.

Por ja që kanë qëlluar
Shurdhmemece,
Pa gojë e sy,
Vesh dhe gjuhë
Andaj s'tregojnë asnjë fjalë,
Për heronjtë dhe maskarenjtë.

101

2.

Flitet se nëpër këto qeli,
Kanë banuar njerëz gjigant,
Perëndi.
Dhe si të tillë përfunduan,
Në kthetrat e komunizmit.

Disa shtrydhnin gjakun e tyre
Prej këmishëve nga torturat
E disave.
Ishte e pamundur
T'i ndalin gazrat nga frika.

Çfarë nuk më kanë treguar
Këto mure të akullta;
Tregonin për titanët e kombit
Dhe për liliputët
Burracakë,
Që frikësoheshin nga hija e tyre.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

2.

Flitet se nëpër këto qeli,
Kanë banuar njerëz gjigant,
Perëndi.
Dhe si të tillë përfunduan,
Në kthetrat e komunizmit.

Disa shtrydhnin gjakun e tyre
Prej këmishëve nga torturat
E disave.
Ishte e pamundur
T'i ndalin gazrat nga frika.

Çfarë nuk më kanë treguar
Këto mure të akullta;
Tregonin për titanët e kombit
Dhe për liliputët
Burracakë,
Që frikësoheshin nga hija e tyre.

102

3.

Sërish po ju them,
Se çfarë nuk kam dëgjuar,
E çfarë nuk flitet
Mes këtyre mureve të mykura.

Disa kanë hyrë këtu,
Për një kohë të gjatë,
Por janë liruar
Pa asnjë therë në këmbë.

Disa dolën me gjymtyrë
Të nakatosura.
Ende nga trutë e tyre
Pikon një trishtim prej maktheve.

Pikon,
sa që gjumi nuk i zë asnjëherë...
Ah,sikur të kishin sy e vesh
Këto lagështi të mureve,
Do tregonin
Për fatin e njerëzve fatkeq.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

3.

Sërish po ju them,
Se çfarë nuk kam dëgjuar,
E çfarë nuk flitet
Mes këtyre mureve të mykura.

Disa kanë hyrë këtu,
Për një kohë të gjatë,
Por janë liruar
Pa asnjë therë në këmbë.

Disa dolën me gjymtyrë
Të nakatosura.
Ende nga trutë e tyre
Pikon një trishtim prej maktheve.

Pikon,
sa që gjumi nuk i zë asnjëherë...
Ah,sikur të kishin sy e vesh
Këto lagështi të mureve,
Do tregonin
Për fatin e njerëzve fatkeq.

103

Çfarë nuk do tregonte  pena
Për heronjtë e vërtet
Dhe maskarenjtë,
Që shiten sot
si heronj të rrejshëm.



***Kush i theu xhamat e shiut  Adem .Z.***

Çfarë nuk do tregonte  pena
Për heronjtë e vërtet
Dhe maskarenjtë,
Që shiten sot
si heronj të rrejshëm.

104

4.

Kam dëgjuar me këto,
veshtë e mi
Se në qelitë me numër
Shtatë,
Tetë,
Dyzet e tetë....
Dëgjoheshin vigmat e padëgjuara.

Më tregoni,
nga cila errësirë
Dilnin me të burgosur,
Dhe hynin pa asnjë njeri,
Arkivolet nëpër këto qeli.

Të nesërmen,
Përgatiteshin transferimet
E kufomave të nakatosura.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

4.

Kam dëgjuar me këto,
veshtë e mi
Se në qelitë me numër
Shtatë,
Tetë,
Dyzet e tetë....
Dëgjoheshin vigmat e padëgjuara.

Më tregoni,
nga cila errësirë
Dilnin me të burgosur,
Dhe hynin pa asnjë njeri,
Arkivolet nëpër këto qeli.

Të nesërmen,
Përgatiteshin transferimet
E kufomave të nakatosura.

105

5.

Më tregonte një mik,
Se si e ka festuar ditëlindjen.

Ishte një festë
E paharruar
Në një dhomë të betontë:
"Gëzuar ditëlindjen e 20 -të në qeli!"

Dikur vonë,
Mbase shumë vonë
Na erdhi “demokracia”.

Si kërpudhat
Filluan të lindin heronjtë.
Brenda natës
Ndryshonin rolet e aktorëve të qelisë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

5.

Më tregonte një mik,
Se si e ka festuar ditëlindjen.

Ishte një festë
E paharruar
Në një dhomë të betontë:
"Gëzuar ditëlindjen e 20 -të në qeli!"

Dikur vonë,
Mbase shumë vonë
Na erdhi “demokracia”.

Si kërpudhat
Filluan të lindin heronjtë.
Brenda natës
Ndryshonin rolet e aktorëve të qelisë.

106

6.

Sot,
takoj burra të heshtur,
Që aq shumë dhanë për atdheun,
Sa që u vjen turp
Të kërthndezen
Si këndesat e dehur.

Kalojnë ballëlart nëpër shëtitoret
E qytetit.
Kalojnë me nga një oreol mbi kokë.
Shoh edhe të tillë
Që zvarriten kokë ulur trotuareve.

Miqtë e mi,
heronjtë gjigant
të asaj kohe
Që sot krahasohen me perënditë.
Dhe njerëz të atij lloji tjetër
Që për mrekulli mësuan
Mjeshtërinë se si ta shikojnë tokën.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

6.

Sot,
takoj burra të heshtur,
Që aq shumë dhanë për atdheun,
Sa që u vjen turp
Të kërthndezen
Si këndesat e dehur.

Kalojnë ballëlart nëpër shëtitoret
E qytetit.
Kalojnë me nga një oreol mbi kokë.
Shoh edhe të tillë
Që zvarriten kokë ulur trotuareve.

Miqtë e mi,
heronjtë gjigant
të asaj kohe
Që sot krahasohen me perënditë.
Dhe njerëz të atij lloji tjetër
Që për mrekulli mësuan
Mjeshtërinë se si ta shikojnë tokën.

107

7.

Më duket se nuk më ka mbetur
Asgjë tjetër,
Përpos asaj
që ta mësoj
Gjuhën,
t'i kem sytë
Dhe veshtë e këtyre mureve.

Ta mësoj artin e deshifrimit,
Të heshtjes,
së shqisave të tjera.

Kështu që
T'i përcjell deri në varr
Perënditë e vërtetë
Dhe maskarenjtë e rrejshëm
Të burgjeve komuniste.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

7.

Më duket se nuk më ka mbetur
Asgjë tjetër,
Përpos asaj
që ta mësoj
Gjuhën,
t'i kem sytë
Dhe veshtë e këtyre mureve.

Ta mësoj artin e deshifrimit,
Të heshtjes,
së shqisave të tjera.

Kështu që
T'i përcjell deri në varr
Perënditë e vërtetë
Dhe maskarenjtë e rrejshëm
Të burgjeve komuniste.

108

8.

Mbrëmë,
qelia X më zuri përbrenda
Katër mureve të mykura
Dhe si në ironi më tha:
"Çile gur gojën!"

Mbase u lëshuan
Perdet e zeza të një kohe
Pas shpine,
Dëgjohej një jehonë e ironizuar;
"Rroftë demokracia!"



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

8.

Mbrëmë,
qelia X më zuri përbrenda
Katër mureve të mykura
Dhe si në ironi më tha:
"Çile gur gojën!"

Mbase u lëshuan
Perdet e zeza të një kohe
Pas shpine,
Dëgjohej një jehonë e ironizuar;
"Rroftë demokracia!"

109

9.

Flitej mes të burgosurve,
Se nëpër këto qeli,
Asnjëherë nuk ka qenë Krishti,
As Muhamedi,
Mbase ishin të padëshirueshëm
Në mesin e këtyre burrave.

Me një rast,
kur një i burgosur
Kërkonte ndihmën e Krishtit
E nxorën nga qelia
Me një arkivol,
Por tani për tani
Nuk më kujtohet ngjyra e qivurit.

Thonë se,
as Zoti nuk ka
Qenë asnjëherë
Nëpër këto dhoma të vogla.

Zota,
kanë qenë gardianët,
Me qafë të dhjamosur,
Duke gogësitur
Deri në vdekje nga dehja.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

9.

Flitej mes të burgosurve,
Se nëpër këto qeli,
Asnjëherë nuk ka qenë Krishti,
As Muhamedi,
Mbase ishin të padëshirueshëm
Në mesin e këtyre burrave.

Me një rast,
kur një i burgosur
Kërkonte ndihmën e Krishtit
E nxorën nga qelia
Me një arkivol,
Por tani për tani
Nuk më kujtohet ngjyra e qivurit.

Thonë se,
as Zoti nuk ka
Qenë asnjëherë
Nëpër këto dhoma të vogla.

Zota,
kanë qenë gardianët,
Me qafë të dhjamosur,
Duke gogësitur
Deri në vdekje nga dehja.

110

## NUK ISHIN KUAJT E PARMENDËS

Ishte një natë pa hënë,
Ndoshta kurrë në vendin tonë
Nuk kishte qenë hëna,
S'kishte qenë
as në Fushën e Mëllenjave.
Ne,
nuk kishim diell
Në grunajat e arta.

Nëpër kalldrëm,
 çdo natë,
Kur i mbyllnin dyert dhe dritaret,
Dëgjonim trokun e egër të kuajve...
S'ishin kuajt e parmendës,
Por të luftës,
Të një tmerri
të pa përshkruar...

Si vajet e fëmijëve për një krodhe buke,
Dëgjoheshin hingëllimat e tmerrit.
Ku ta shohim hënën,
Kur në shpirtin tonë të hidhur
Kishte shumë trishtim,
Çdo herë e shikonim diellin e leckosur.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

NUK ISHIN KUAJT E PARMENDËS

Ishte një natë pa hënë,
Ndoshta kurrë në vendin tonë
Nuk kishte qenë hëna,
S'kishte qenë
as në Fushën e Mëllenjave.
Ne,
nuk kishim diell
Në grunajat e arta.

Nëpër kalldrëm,
 çdo natë,
Kur i mbyllnin dyert dhe dritaret,
Dëgjonim trokun e egër të kuajve...
S'ishin kuajt e parmendës,
Por të luftës,
Të një tmerri
të pa përshkruar...

Si vajet e fëmijëve për një krodhe buke,
Dëgjoheshin hingëllimat e tmerrit.
Ku ta shohim hënën,
Kur në shpirtin tonë të hidhur
Kishte shumë trishtim,
Çdo herë e shikonim diellin e leckosur.

111

Kishte diçka të mistershme në fatin tonë!
Në fillimin e pranverës,
Na vinin ushtritë huaja
Me disa lloje veladonësh.

Kurse në vjeshtë ktheheshin
Pa pushkë dhe trasta,
Ktheheshin me letrat e grisura dashurisë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Kishte diçka të mistershme në fatin tonë!
Në fillimin e pranverës,
Na vinin ushtritë huaja
Me disa lloje veladonësh.

Kurse në vjeshtë ktheheshin
Pa pushkë dhe trasta,
Ktheheshin me letrat e grisura dashurisë.

112

## SA LARG ...

Sa larg njëri-tjetrit jemi,
E sa afër hënën e kemi,
Në çdo kohë
Mund ta prekim me dorë.

Kurse ti,
mua mund të me prekësh,
Vetëm në mendimet e tua.

Sa larg njëri – tjetrit jemi,
Aq sa s'mund t'i shohim fotografitë tona.

Një hënë e leckosur,
Për çdo natë më afrohet,
Me duart dhe fjalët e saj sublime
Shëron plagët
që s'kanë të shëruar.

Sa larg njëri-tjetrit jemi ...
Ndoshta njëmijë vjet drite,
Jemi larg,
ose jemi larguar
Për një arsye shumë banale.



***Kush i theu xhamat e shiut Adem .Z.***

SA LARG ...

Sa larg njëri-tjetrit jemi,
E sa afër hënën e kemi,
Në çdo kohë
Mund ta prekim me dorë.

Kurse ti,
mua mund të me prekësh,
Vetëm në mendimet e tua.

Sa larg njëri – tjetrit jemi,
Aq sa s'mund t'i shohim fotografitë tona.

Një hënë e leckosur,
Për çdo natë më afrohet,
Me duart dhe fjalët e saj sublime
Shëron plagët
që s'kanë të shëruar.

Sa larg njëri-tjetrit jemi ...
Ndoshta njëmijë vjet drite,
Jemi larg,
ose jemi larguar
Për një arsye shumë banale.

113

**KU ISHE TI?!**

Ku ishe ti, kur këndonin,
Këndesat e mëngjesit?!
Nën cilin yll
I kërkoje letrat e dashurisë?

Nuk më kujtohen çastet
Kur erdhi pranvera,
Ose kur shkoi dimri.

Nën cilin yll i kërkoje duart e mia?!

Në kohën tonë të largët
Pranverat nuk çelnin lule.
Të kujtohet fare mirë
Se asnjë lule nuk ta solla për ditëlindje.

Ku ishe ti,
kur kaloi ekuinoksi
Nëpër lagjen tonë?!
Mos vrapoje pas mjegullave
Të cilët asnjëherë nuk i zure?!



***Kush i theu xhamat e shiut  Adem .Z.***

**KU ISHE TI?!**

Ku ishe ti, kur këndonin,
Këndesat e mëngjesit?!
Nën cilin yll
I kërkoje letrat e dashurisë?

Nuk më kujtohen çastet
Kur erdhi pranvera,
Ose kur shkoi dimri.

Nën cilin yll i kërkoje duart e mia?!

Në kohën tonë të largët
Pranverat nuk çelnin lule.
Të kujtohet fare mirë
Se asnjë lule nuk ta solla për ditëlindje.

Ku ishe ti,
kur kaloi ekuinoksi
Nëpër lagjen tonë?!
Mos vrapoje pas mjegullave
Të cilët asnjëherë nuk i zure?!

114

**NËSE NUK MË ZGJON KAM FRIKË**

Ne e dimë ,
se tani është koha
Kur gurët duhet të çelin lule,
Të çelin aguliçet,
Me të gjitha ngjyrat e dynjasë,
Të çelin në sytë e kaltër të vashave.

Hë pra,
vëre atë gur në zemrën time!
Le të çeli lulen më të bukur për ty,
E di,
nesër ke ditëlindjen...
Di dhe çfarë lule meriton
Zemra e jote e vogël,
me një shpirt të madh.

Në qoftë se gaboj,
Të lutem më trego,
Se kur vjen koha e gurëve të çelin lule?
Të ta sjell më të bukurën,
atë që në asnjë kohë,
nuk vdes nga dhembja.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

**NËSE NUK MË ZGJON KAM FRIKË**

Ne e dimë ,
se tani është koha
Kur gurët duhet të çelin lule,
Të çelin aguliçet,
Me të gjitha ngjyrat e dynjasë,
Të çelin në sytë e kaltër të vashave.

Hë pra,
vëre atë gur në zemrën time!
Le të çeli lulen më të bukur për ty,
E di,
nesër ke ditëlindjen...
Di dhe çfarë lule meriton
Zemra e jote e vogël,
me një shpirt të madh.

Në qoftë se gaboj,
Të lutem më trego,
Se kur vjen koha e gurëve të çelin lule?
Të ta sjell më të bukurën,
atë që në asnjë kohë,
nuk vdes nga dhembja.

115

Po mbeta pa kujtesë,
Ti më picko me gishtat e tua të holla.
Më picko fort,
që të zgjohet stina te mua!

Nëse nuk më zgjon,
kam frikë
Se do vdesin gurët dhe lulet në vjeshtë.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Po mbeta pa kujtesë,
Ti më picko me gishtat e tua të holla.
Më picko fort,
që të zgjohet stina te mua!

Nëse nuk më zgjon,
kam frikë
Se do vdesin gurët dhe lulet në vjeshtë.

116

## GATUAN EMRIN E ATDHEUT TIM

Këto fusha të gjëra
I përkasin vendit tim.
Diellit dhe hënës,
kur lind dhe perëndon.
Shikoni sa janë të pëlleshme,
Si hartat e Ptolomeut,
në anijet e fundosura.

Kjo tokë e ky atdhe,
s'janë të varfër.
Kanë një gjuhë me  tri fe.

Unë them,
Mirëmëngjesi!
Ai më thotë,
Mirëdita!
Kurse i treti,
gjithë gëzim,
ma kthen,
Natën e mirë!

Këtë tokë të bekuar nga perënditë,
Askush nuk e solli këtu,
Kur zbritën nga qielli, etërit e mi



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

GATUAN EMRIN E ATDHEUT TIM

Këto fusha të gjëra
I përkasin vendit tim.
Diellit dhe hënës,
kur lind dhe perëndon.
Shikoni sa janë të pëlleshme,
Si hartat e Ptolomeut,
në anijet e fundosura.

Kjo tokë e ky atdhe,
s'janë të varfër.
Kanë një gjuhë me  tri fe.

Unë them,
Mirëmëngjesi!
Ai më thotë,
Mirëdita!
Kurse i treti,
gjithë gëzim,
ma kthen,
Natën e mirë!

Këtë tokë të bekuar nga perënditë,
Askush nuk e solli këtu,
Kur zbritën nga qielli, etërit e mi

117

S’takuan,
asnjë njeri në këto anë.

Nga ne,
ardhacakët mësuan se si ndizet zjarri.

Ju thashë,
se çdo gur e shkëmb
I përket vendit tim!

Edhe mëllenjat e grunajave të arta,
Me një mjeshtri misterioze
Gatuan emrin e atdheut tim.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

S’takuan,
asnjë njeri në këto anë.

Nga ne,
ardhacakët mësuan se si ndizet zjarri.

Ju thashë,
se çdo gur e shkëmb
I përket vendit tim!

Edhe mëllenjat e grunajave të arta,
Me një mjeshtri misterioze
Gatuan emrin e atdheut tim.

118

## ATA JETOJNË SOT PËR NESËR

Dje s'kisha asgjë në duar e mia,
Nuk kam as sot,
Nuk di për ku jam nisur
Dhe ku mund të ndalen ëndrrat e mia.
Në cilin det,
do i gjej rremat e varkës së thyer.

Gaboni shumë,
nëse mendoni
Se poetët dinë çdo gjë.

Ata jetojnë sot për nesër,
Për një gotë të rakisë së rrushit,
Japin shtatë prostituta të moshuara.

Kanë vetëm një intuitë të përkryer.
Nga secila muzë
Janë në gjendjen ta mjelin të bukurën,
Dhe të lozin në një kitarë të vjetër.
Derisa dehen këndesat e mëngjesit.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

ATA JETOJNË SOT PËR NESËR

Dje s'kisha asgjë në duar e mia,
Nuk kam as sot,
Nuk di për ku jam nisur
Dhe ku mund të ndalen ëndrrat e mia.
Në cilin det,
do i gjej rremat e varkës së thyer.

Gaboni shumë,
nëse mendoni
Se poetët dinë çdo gjë.

Ata jetojnë sot për nesër,
Për një gotë të rakisë së rrushit,
Japin shtatë prostituta të moshuara.

Kanë vetëm një intuitë të përkryer.
Nga secila muzë
Janë në gjendjen ta mjelin të bukurën,
Dhe të lozin në një kitarë të vjetër.
Derisa dehen këndesat e mëngjesit.

119

Ja pra përse,
dje s'kisha asgjë nëpër duar.
Vrapoja rrugëve pa asnjë ëndërr,
Vrapoja deri atje
Ku për çdo mëngjes,
zbresin shirat
Zbresin për t'i lagur
flokët e mia të thinjura.



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

Ja pra përse,
dje s'kisha asgjë nëpër duar.
Vrapoja rrugëve pa asnjë ëndërr,
Vrapoja deri atje
Ku për çdo mëngjes,
zbresin shirat
Zbresin për t'i lagur
flokët e mia të thinjura.

120

## ERA NË MULLIRIN E SAJ MAGJIK

Si mrekullia e Zotit po rigon
Ky shi i egër,
Mos vallë retë e harlisura
I bluajnë gurët e qiellit?!

Nuk jam në gjendje të kuptoj asgjë
As këto fenomene kozmike...
Kurse gurët,
po reshin
Në cifla rigash të shiut.

I zgjas duart në drejtim të qiejve,
S'mund t'i prek mjegullat era,
në mullirin e saj magjik.
Bluan e bluan gur prej mjegulle...



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

ERA NË MULLIRIN E SAJ MAGJIK

Si mrekullia e Zotit po rigon
Ky shi i egër,
Mos vallë retë e harlisura
I bluajnë gurët e qiellit?!

Nuk jam në gjendje të kuptoj asgjë
As këto fenomene kozmike...
Kurse gurët,
po reshin
Në cifla rigash të shiut.

I zgjas duart në drejtim të qiejve,
S'mund t'i prek mjegullat era,
në mullirin e saj magjik.
Bluan e bluan gur prej mjegulle...

121

## OSE I BIRI E VAJTONTE TË ATIN

Nga telat e këputura të kitarës,
Zgjohet një zë prej guri.
Era,
këndon një psalmë të lashtë.
Nga muret e korridorit,
zbresin zërat e shthurura të ikonave.

Më pastaj,një heshtje pas heshtjeje,
këputen telat e ndryshkura.

Nga vajet i foshnjave,
te portat e faltores
Kurrë më trishtueshëm se sot,
Nuk është dëgjuar,
dënesja e tokës tonë.

Tok me foshnjat,
qante edhe kambana.
Një dënesje në duet
Dëgjohej lart në qiell,
S’dihet,
a thua vallë Ati e vajtonte të Birin,
apo i Biri të Atin fatkeq?!



***Kush i theu xhamat e shiut   Adem .Z.***

OSE I BIRI E VAJTONTE TË ATIN

Nga telat e këputura të kitarës,
